



**PLANI I PËRMIRËSIMIT TË SHËRBIMIT PËR  
ARSIMIN PARASHKOLLOR  
BASHKIA RROGOZHINË**



Tetor 2024

## Përmbajtja

1. Hyrje .....	3
1.1 Qëllimi .....	3
1.2 Shtrirja.....	4
1.3 Vizioni.....	4
1.4 Misioni .....	4
1.5 Objektivat.....	4
1.6 Përgjegjësit.....	4
2. Procesi i Menaxhimit - Veprimet e Planit të Përmirësimit të Shërbimit .....	5
2.1 Qëllimi.....	5
2.2 Objektiva të përgjithshëm të proceseve të menaxhimit.....	5
2.3 Regjistrimi i fëmijëve .....	5
2.3.1 Regjistrimi i fëmijëve në kopsht.....	5
2.4 Organizmat e Institucionit Arsimor .....	10
2.4.1 Këshilli i Prindërve, Bordi i Kopshtit, Komisioni i Shëndetit, Sigurisë, Mirëmbajtjes dhe Mjedisit .....	10
3. Proceset Kryesore - Veprimet e Planit të Përmirësimit të Shërbimit.....	20
3.1 Qëllimi.....	20
3.2 Objektiva të përgjithshëm të proceseve kryesore.....	20
3.3 Përfshirja sociale .....	21
3.3.1 Identifikimi i nevojave për përfshirje .....	21
3.5 Fëmijët me aftësi të kufizuara.....	24
3.5.1 Adresimi i prindërve .....	24
4. Proceset Mbështetëse - Veprimet e Planit të Përmirësimit të Shërbimit .....	28
4.1 Qëllimi.....	28
4.2 Objektiva të përgjithshëm .....	28
4.3 Burimet Njerëzore.....	28
4.3.1 Rekrutimi i stafit .....	28
4.3.2 Trajnimi i stafit .....	30
4.4 Menaxhimi i godinave .....	34
4.4.1 Rikonstruksioni i kopshteve.....	34
4.5 Materialet .....	37
4.5.1 Planifikimi i nevojës për materiale .....	37
5. Buxheti.....	39
6. Lista e Plotë e aktiviteteve/projekteve .....	40
7. Pasaportat e Treguesve dhe Objektivave të Planit.....	43

## 1. Hyrje

Qëllimi i këtij plani është hartimi i një platforme strategjike dhe gjithëpërfshirëse që do të hedhë bazat për një zhvillim të qëndrueshëm dhe cilësor për të gjitha strukturat e Arsimit parashkollor. Arsimi, konsiderohet si një nga sektorët me impakt të drejtpërdrejtë në mirëqënien sociale dhe ekonomike të Bashkisë Rrogozhinë. Plani i përmirësimit synon të përmbushë nevojën për të harmonizuar të gjitha aktivitetet zbatuese në një vizion të përbashkët dhe koherent të fokusuar në disa objektiva strategjik.

Gjatë analizimit të situatës, është evidentuar si problematikë kryesore në Bashkinë Rrogozhinë, ka një rënie të numrit të fëmijëve të regjistruar në kopshte krahasuar me vitin e kaluar 2022-2023, çka ka çuar në krijimin e grupeve të përziera dhe shumë vende të lira në kopshte. Strukturat organizative si Bordi dhe Këshilli i Prindërve nuk janë themeluar në të gjitha kopshtet, ndërsa infrastruktura specifike dhe dokumentacioni për fëmijët me aftësi të kufizuara është e pamjaftueshme dhe në disa kopshte mungon. Disa kopshte ndajnë të njëjtat ambiente me shkollat dhe kanë nevojë për riparime në sistemet elektrike dhe hidraulike. Në Bashkinë Rrogozhinë është vetëm 1 drejtor për kopshtin e qytetit, kurse në kopshtet e tjera janë drejtuesit e shkollave shpesh ata që menaxhojnë edhe kopshtet. Gjithashtu, bashkia nuk ofron transport të dedikuar për fëmijët, të cilët dërgohen në kopshte nga prindërit me mjetet e tyre.

### 1.1 Qëllimi

Plani do të ketë një rol shumë të rëndësishëm për Bashkinë Rrogozhinë dhe ai synon të përmirësojë në mënyrë të ndjeshme të gjitha proceset që lidhen me arsimin parashkollor. Konkretisht nëpërmjet planit synohet:

- Përmirësimi i shërbimeve në kopshte për të rritur regjistrimet në ato ku ka mungesa.
- Planifikim strategjik për riorganizimin e infrastrukturës, veçanërisht në kopshtet që ndodhen brenda shkollave apo ato që kërkojnë restaurim urgjent.
- Zhvillimi i burimeve njerëzore në nivel bashkie për çështje të arsimit parashkollor, duke përfshirë ndërgjegjësimin e drejtuesve dhe administratës për zbatimin e planeve për përmirësim.
- Krijimi i një databaze efektive për menaxhimin e strukturave të arsimit parashkollor, duke siguruar respektimin e kërkesave ligjore dhe forcimin e kuadrit rregullator për të shmangur shkeljet.
- Bashkëpunim i ngushtë me prindërit dhe komunitetin për të ndërgjegjësuar mbi rëndësinë e kopshtit në zhvillimin e fëmijëve.

Në pjesën e parë të dokumentit gjendet një analizë përmbajtësore e cila do të përmbajë Vizionin, Misionin, Objektivat Strategjik të Planit, personat përgjegjës për implementimin, monitorimin dhe zhvillimin e tij.

Në pjesën e dytë dokumenti fokusohet në vendosjen e Objektivave të përgjithshëm dhe specifik për secilin proces. Për të lehtësuar procesin e implementimit të planit, janë vendosur edhe indikatorët e performancës si dhe objektivat specifik për secilin kriter të përgjithshëm dhe më pas aktivitetet që duhen ndërmarrë për të arritur objektivat e vendosur.

Ndërkohë në pjesën e tretë është përmbledhur buxheti i nevojshëm për të realizuar ndërhyrjet në terren me qëllim rritjen e cilësisë në arsimin parashkollor.

## 1.2 Shtrirja

Plani synon të përmirësojë shërbimin e Arsimit Parashkollor në Bashkinë e Rrogozhinë. Plani do të zbatohet në të gjitha kopshtet që janë nën juridiksionin e Bashkisë dhe ka një afat zbatimi prej 3 vitesh. Për mbarëvajtjen e aktiviteteve të planit dhe monitorimin e tij do të kujdeset Drejtoria e Arsimit, Kulturës dhe Drejtoria e Burimeve Njerëzore.

## 1.3 Vizioni

Të ndërtojmë një të ardhme ku çdo fëmijë gjen mbështetje dhe përkujdesje në hapat e parë të rrugëtimit të tij edukativ, përmes strukturave të përkushtuara që i japin jetë mundësive të barabarta dhe zhvillimit të plotë për të gjithë. Në çdo hap e në çdo grup, të krijojmë një mjedis që nxit kuriozitetin, kultivon talentin dhe ushqen ëndrrat, duke ndërtuar bazat për një arsim parashkollor të përmirësuar dhe gjithëpërfshirës, ku secili fëmijë ndihet i përfaquar dhe i përfshirë.

## 1.4 Misioni

Fuqizimi i strukturave të arsimit parashkollor me qëllim përmbushjen e nevojave të fëmijëve dhe rritjen e cilësisë së shërbimeve edukative dhe mbështetëse në këtë fazë kyçe të zhvillimit të tyre.

## 1.5 Objektivat

- Përmirësimi i ofrimit të shërbimit në kopshte nëpërmjet organizimit të regjistrimeve sipas vendbanimeve;
- Përmirësimi i infrastrukturës së kopshteve;
- Ulja e numrit të grupeve të përziera në kopshte nëpërmjet përmirësimit të infrastrukturës;
- Ngritja dhe fuqizimi i strukturave mbështetëse të kopshtit (Bordi dhe këshilli i prindërve, komisioni i shëndetit, sigurisë, mirëmbajtjes dhe mjedisit;
- Përmirësimi i procesit të identifikimit dhe shërbimit të fëmijëve në nevojë për mbrojtje, me aftësi të kufizuar dhe në nevojë për përfshirje sociale.

## 1.6 Përgjegjësit

1. Koordinator i planit:
  - Personi përgjegjës për Sektorin e Arsimit, i cili kujdeset për zbatimin e planit nga të gjithë aktorët përgjegjës;
2. Aktorët zbatues të planit:
  - Drejtuesit e kopshtit;
  - Mësueset e kopshtit;
  - Komuniteti;
  - Punonjësit për Mbrojtjen e Fëmijëve (PMF);
  - Psikologët;
  - Grupi Teknik Ndërsektorial (GTN);
  - Grupet e terrenit.
3. Monitorues/vlerësues i planit:
  - Kryetari i Bashkisë;
  - Këshilli i Bashkisë.

## 2. Procesi i Menaxhimit - Veprimet e Planit të Përmirësimit të Shërbimit

### 2.1 Qëllimi

Proceset e menaxhimit vendosin objektiva strategjike dhe kushte kuadër për funksionimin e sistemit, duke përfshirë planifikimin, menaxhimin dhe kontrollin e cilësisë. Planifikimi i arsimit parashkollor bazohet në numrin e parashikuar të fëmijëve të moshës 3-6 vjeç, normën e regjistrimit dhe frekuentimit, duke marrë parasysh që arsimit parashkollor në Shqipëri nuk është i detyrueshëm. Kjo përfshin gjithashtu parashikimin e ofertës, si numrin e mësuesve dhe stafit mbështetës. Plani për përmirësimin e shërbimit synon të ulë mbipopullimin, të rrisë regjistrimet dhe të përmirësojë cilësinë e kopshtit.

### 2.2 Objektiva të përgjithshme të proceseve të menaxhimit

Objektivat e përgjithshme të këtij plani në lidhje me Proceset e Menaxhimit janë:

1. Të rritet regjistrimi i fëmijëve sipas zonës së tyre të banimit dhe të shtohet pjesëmarrja përmes ndërgjegjësimit të prindërve dhe komunitetit për rëndësinë e arsimit parashkollor.
2. Ta transformojmë kopshtin në një qendër të gjallë komunitare ku prindërit dhe anëtarët e komunitetit angazhohen aktivisht për të mbështetur zhvillimin e fëmijëve dhe për të përmirësuar shërbimet edukative.
3. Të themelohen dhe fuqizohen struktura si Këshilli i Prindërve, Bordi i Kopshtit, dhe Komisioni i Shëndetit, Sigurisë, Mirëmbajtjes dhe Mjedisit, me qëllim që të rritet ndikimi i tyre në proceset e menaxhimit të kopshteve..

### 2.3 Regjistrimi i fëmijëve

#### 2.3.1 Regjistrimi i fëmijëve në kopsht

##### *Informacion i përgjithshëm*

Numri i fëmijëve të regjistruar në kopshtet publike të Bashkisë Rrogozhinë është 334, prej të cilëve 161 janë vajza. Bashkia Rrogozhinë ka kapacitetet akomodues për **630, ndërkohë ka të regjistruar për vitin shkollor 2023-2024, 334 fëmijë në kopshtet publike. Gjithsej 300 fëmijë ndjekin kopshtin.**

Një faktor tjetër i rëndësishëm që ndikon ndjeshëm në numrin e regjistrimit është përmirësimi i infrastrukturës së kopshtit. Sipas bashkisë kopshtet në godinë më vete ose që janë rikonstruktuar së fundmi kanë numër më të lartë fëmijësh të regjistruar. E njëjta situatë vihet re edhe për kopshtet e reja të cilat kanë numër të lartë regjistrimesh.

Ndërkohë, ndarja e fëmijëve në grupe sipas grupmoshës mbetet akoma problematike për disa NjA. Sipas të dhënave vihet re që numri i fëmijëve të regjistruar në grupet e përziera është 160. Pozitiv është fakti që në këtë bashki ka një numër të lartë fëmijësh të regjistruar në grupin e tretë, konkretisht **63 fëmijë.**

##### *Objektiva specifike:*

Planifikimi i të gjithë sistemit parashkollor mbështetur në numrin e parashikuar të fëmijëve në moshën e kopshtit 3-6 vjeç, normën e pritshme të regjistrimit, si dhe shkallën e pritshme të frekuentimit për të siguruar një shërbim efikas.

##### *Nën-objektivat:*

Nr	Pershkrimi
----	------------

<b>Nr</b>	<b>Pershkrimi</b>
1	Unifikimi i të dhënave të arsimit parashkollor mes Bashkisë, ZVAP, NJA dhe kopshteve
2	Ulja e numrit të grupeve të përziera dhe fëmijëve në këto grupe
3	Rritja e regjistrimit të fëmijëve në kopshte
4	Identifikimi i fëmijëve në moshë kopshti në Bashkinë Rrogozhinë
5	Rregullimi i procedurës së regjistrimit nëpërmjet hartimit dhe zbatimit të akteve formale

*Lista e Projekteve*

<b>Nr.</b>	<b>Projekti</b>	<b>Buxheti Fakt 2024</b>	<b>Buxhet Vit 2025</b>	<b>Buxhet Vit 2026</b>	<b>Buxhet Vit 2027</b>	<b>Shuma periudhe</b>
001	Regjistrimi i fëmijëve sipas zonës së banimit					
002	Krijimi i regjistrit elektronik i cili përmban të dhëna analitike për kopshtet.					

*Përshkrimi i projekteve*

Nr. 001	<b>Projekti:</b> Regjistrimi i fëmijëve sipas zonës së banimit	<b>Programi Buxhetor:</b> 09120 - Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor <b>Funksioni:</b> 09
<b>a) Përshkrim i shkurtër i projektit</b>		
<b>i Situat</b>		
<p>Regjistrimi i fëmijëve në kopshte bëhet kryesisht sipas vendbanimit të tyre, por në raste të veçanta lejohet edhe regjistrimi jashtë zonës për të përmbushur nevojat e familjeve, veçanërisht kur kopshti ka vende bosh. Kjo situatë ndodh shpesh për shkak të punësimit të prindërve në afërsi të kopshtit, duke u mundësuar atyre që të kenë akses më të lehtë në shërbimet edukative për fëmijët e tyre. Prioritet u jepet gjithashtu fëmijëve në nevojë, ku bashkia bashkëpunon ngushtësisht me shërbimet sociale për të mundësuar regjistrimin e fëmijëve pranë vendit të punës së prindërve ose pranë shtëpive të gjyshërve, për të garantuar një mbështetje më të madhe për këto familje.</p> <p>Në lidhje me marrëdhëniet mes prindërve dhe kopshteve, është hartuar një kontratë tip mes prindërve dhe kopshtit, e cila zbatohet vetëm për kopshtet që ofrojnë ushqim. Kjo kontratë ndihmon në përcaktimin e përgjegjësive dhe pritshmërive të dy palëve, ndërsa për kopshtet e tjera nuk ka një strukturë të tillë, çka mund të shkaktojë paqartësi në marrëdhëniet mes prindërve dhe stafit të kopshtit.</p>		
<b>Përmbledhje e problematikës dhe nevoja për ndërhyrje</b>		
<p>Shpërndarja e paekuilibruar e fëmijëve në kopshte çon në mbipopullim në disa institucione dhe nënpopullim në të tjerë. Ky mbipopullim shkakton vështirësi në procesin e edukimit dhe menaxhimit të fëmijëve, duke ndikuar në cilësinë e shërbimeve edukative. Nga ana tjetër, nënpopullimi bën që hapësirat, të cilat janë investuar dhe janë në gjendje shumë të mirë, të mos shfrytëzohen maksimalisht.</p>		
<b>ii Synimi i projektit</b>		
<p>Ky projekt ka për qëllim të sigurojë një shpërndarje të barabartë të fëmijëve në kopshte, duke garantuar që cilësia e shërbimeve edukative të jetë e njëjtë për të gjitha institucionet. Regjistrimi i fëmijëve do të kryhet kryesisht sipas zonës së banimit, në vend të preferencave individuale të prindërve. Për këtë, projekti do të fokusohet në hartimin dhe zbatimin e një rregulloreje që do të udhëheqë të gjitha kopshteve në procesin e regjistrimit, duke garantuar kështu një qasje të drejtë dhe transparente për të gjithë fëmijët dhe familjet.</p>		
<b>iii Niveli i ndërhyrjes</b>		
<b>1. Një model i rregullores mund të jetë si më poshtë:</b>		
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Prindërit, përveç dokumenteve të tjera, duhet të dorëzojnë edhe Certifikatën e Vendbanimit. Afati për dorëzimin e dokumenteve është nga 1 deri më 10 qershor.</li> <li>• Kopshti dorëzon dokumentet e marra nga prindërit në Drejtoria e Arsimit brenda 2 ditëve pas përfundimit të afatit të regjistrimit.</li> <li>• Drejtoria e Arsimit shqyrton dokumentet dhe, bazuar kriteret ligjore (*sipas zonës së banimit) dhe vendos mbi pranimin dhe shpërndarjen e fëmijëve në kopshte. Afati për kryerjen e regjistrimeve dhe marrjen e vendimeve është deri në fund të qershorit. Gjatë kësaj kohe punohet për identifikimin dhe regjistrimin në vijimi të fëmijëve që ende nuk janë regjistruar në kopshte.</li> </ul> <p>2. <b>Marrëveshja Prindër-Kopsht:</b> Hartimi dhe zbatimi i kontratës mes prindërve dhe kopshtit, kontratë në të cilën përcaktohen të drejtat dhe detyrimet e secilës palë.</p> <p>3. <b>Takimet me prindërit dhe identifikimi e regjistrimi i fëmijëve në nevojë:</b> Pas përfundimit të regjistrimeve, drejtorët apo mësuesit e kopshtit takojnë prindërit që nuk kanë regjistruar fëmijët e tyre për të kuptuar arsyet dhe për t'i informuar mbi rëndësinë e arsimit parashkollor. Kjo punë kryhet gjithashtu edhe prej punonjësve të terrenit për të identifikuar fëmijët në situatë rruge.</p>		
<b>iv Aktivitetet kryesore të projektit</b>		
<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Shqyrtimi i aplikimeve dhe marrja e vendimit;</li> <li>2. Hartimi i një kontrate tip mes prindërve dhe kopshteve;</li> <li>3. Identifikimi i fëmijëve që nuk janë regjistruar në kopsht;</li> <li>4. Takime me prindërit për regjistrimin e fëmijëve.</li> </ol>		
<b>b) Rezultatet që prisni (shërbimet apo produktet e pritshme)</b>		
<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Regjistrimi i fëmijëve sipas zonës së banimit;</li> <li>2. Shpërndarje e njëjtë e regjistrimit të fëmijëve;</li> <li>3. Rritje e numrit të regjistrimeve;</li> <li>4. Ulje e numrit të grupeve të përziera dhe/ose numrit të fëmijëve në këto grupe.</li> </ol>		
<b>Aktorët e mundshëm:</b> (njësitë e përfshira   <b>Kontributet e mundshme në projekt</b> (institucione		



brenda bashkisë)		qendrore, OJF, donator, etj.)				
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Kryetar i Bashkisë</li> <li>• Drejtues/mësues/Grupet e Terrenit</li> <li>• Mësuese</li> </ul>		<ul style="list-style-type: none"> <li>• Prindërit/Persona me përgjegjësi prindërore</li> <li>• Drejtues/mësues të kopshteve</li> <li>• Grupet e Terrenit</li> </ul>				
<b>e) Shpenzimet e llogaritura<sup>1</sup></b> (për çdo aktivitet të mësipërm pika iv)						
Nr	Emërtimi	Buxheti faktik	Buxheti Viti 2025	Buxheti Viti 2026	Buxheti Viti 2027	Shuma
1	Shqyrtimi i aplikimeve dhe marrja e vendimit					
2	Hartimi i një kontrate tip mes prindërve dhe kopshteve					
3	Identifikimi i fëmijëve që nuk janë regjistruar në kopsht					
4	Takime me prindërit për regjistrimin e fëmijëve					
	<b>Shuma</b>					0
<b>f) Periudha e zbatimit:</b>			<b>g) Ndjek zbatimin e projektit:</b>			
2025 2026 2027			Drejtoria e Arsimit (sektori arsimit parashkollor)			

<b>Nr. 002</b>	<b>Projekti:</b> Krijimi i regjistrimit elektronik i cili përmban të dhëna analitike për kopshtin	<b>Programi Buxhetor:</b> - 09120 - Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor <b>Funksioni: 09</b>
<b>a) Përshkrim i shkurtër i projektit</b>		
<b>i Situata</b>		
Bazuar në Ligjin Nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", në Nenin 23, bashkitë janë përgjegjëse në territorin e tyre për administrimin dhe rregullimin e sistemit arsimor parashkollor në kopshte dhe çerdhe. Në Bashkinë Rrogozhinë nuk ka një planifikim të qartë për identifikimin e numrit të parashikuar të fëmijëve 3-6 vjeç që do të frekuentojnë kopshtet. Gjithashtu gjatë punës për diagnostikimin dhe përgatitjen e raporteve analitike të situatës të Arsimit Parashkollor u vu re një mosrakordim i të dhënave mes ZVAP, Bashkisë, NjA-ve dhe kopshteve.		
<b>Përmbledhje e problematikës dhe nevoja për ndërhyrje</b>		
Në Bashkinë Rrogozhinë, nuk merren të dhëna nga institucionet e tjera për fëmijët në moshë kopshti 3-6 vjeç dhe si pasojë nuk bëhet një planifikim i mirëfilltë për identifikimin e numrit të parashikuar të fëmijëve 3-6 vjeç të cilët do të frekuentojnë kopshtin. Mosrakordimi i të dhënave pengon diagnostikimin e saktë të situatës, identifikimin e problemeve dhe nevojën për ndërhyrje. Mungesa e një databaze të unifikuar mes institucioneve vështirëson marrjen e vendimeve, si për mbylljen e kopshteve nën kapacitet, ashtu edhe për ndërtimin e kopshteve të reja.		
<b>ii Synimi i projektit</b>		
Krijimi i një sistemi të unifikuar i të dhënave (regjistri në formatin excel) në kohë reale për të përmirësuar planifikimin dhe ofrimin e shërbimeve më efikase nga institucionet përkatëse.		
<b>Mbledhja e të dhënave:</b>		

<sup>1</sup> Ky aktivitet nuk parashikon shpenzime/buxhet shtesë. Kostot përfshijnë pagat e punonjësve të angazhuar në punë, koosto që përfshijë zërat ekzistues të shpenzimeve për paga dhe kontributet e sigurimeve shoqërore.



<ul style="list-style-type: none"> <li>○ Marrja e informacionit nga Zyrat e Gjendjes Civile pranë bashkisë ose Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile për numrin e fëmijëve në moshën e regjistrimit në kopshte sipas njësive administrative, grupmoshës dhe gjinisë (shkresë).</li> <li>○ Konsultimi me Administratorët e njësive administrative për të përfshirë të dhënat mbi numrin e fëmijëve sipas njësive administrative, grup moshës dhe gjinisë. Administratorët e njësive mund ta mbledhin këtë të dhënë në territory.</li> <li>○ Mbledhja e të dhënave nga drejtuesit e kopshteve ose mësuesit përgjegjës për numrin aktual të fëmijëve të regjistruar në kopsht sipas njësive administrative dhe gjinisë.</li> <li>○ Mbledhja e të dhënave nga listat e fëmijëve të vaksinuar të moshës 3-6 vjeç nga Qendrat Shëndetësore.</li> <li>○ Koordinimi me Drejtorinë e Shërbimit Social për të identifikuar fëmijët që ndodhen në situatë rruge të moshës 3-6 vjeç.</li> <li>○ Marrja e informacionit nga Drejtoria e Ndihmës Ekonomike dhe Programi për Aftësi të Kufizuara (PAK) për identifikimin e fëmijëve me aftësi ndryshe.</li> <li>○ Marrja e informacionit nga sistemi i të dhënave të Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e Fëmijëve</li> </ul>						
<b>iii Niveli i ndërhyrjes</b>						
<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Hartimi i një marrëveshjeje bashkëpunimi ndërmjet Bashkisë dhe ZVAP për raportimin e numrit të fëmijëve në kopshte, duke shmangur raportimin direkt nga kopshtet.</li> <li>2. Dërgimi i informacioneve të detajuara te Sektori i Arsimit parashkollo.</li> <li>3. Plotësimi i të dhënave në regjistrin e shërbimit nga Sektori i Arsimit parashkollor, Drejtoria e Shërbimeve Sociale dhe Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit.</li> <li>4. Gjenerimi i analizave dhe planifikimi i ndërhyrjeve nga Sektori i Arsimit.</li> <li>5. Dërgimi i të dhënave te ZVAP dhe Njësitë Administrative.</li> </ol>						
<b>iv Aktivitetet kryesore të projektit</b>						
<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Krijimi i një regjistri me të dhënat analitike të kopshteve dhe gjenerimi i analizave.</li> <li>2. Hedhja e të dhënave në mënyrë periodike.</li> </ol>						
<b>b) Rezultatet që prisni (shërbimet apo produktet e pritshme)</b>						
<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Regjistri elektronik me të dhënat individuale të kopshteve të plotësuara në kohë reale</li> <li>2. Analiza e Situatës së kopshteve dhe planifikimi i ndërhyrjeve</li> <li>3. Koordinimi më i mirë Ndërinstitucional</li> </ol>						
Aktorët e mundshëm: (njësitë e përfshira brenda bashkisë)				Kontributet e mundshme në projekt (institucione qendrore, OJF, donator, etj.)		
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Njësitë administrative</li> <li>• Drejtoria e Shërbimit Social</li> </ul>				<ul style="list-style-type: none"> <li>• ZVAP;</li> </ul>		
<b>e) Shpenzimet e llogaritura<sup>2</sup> (për çdo aktivitet të mësipërm pika iv)</b>						
Nr	Emertimi	Buxheti Faktik 2024	Buxheti Viti 2025	Buxheti Viti 2026	Buxheti Viti 2027	Shuma
1	Krijimi i një regjistri me të dhëna analitike për kopshtet.					
2	Trajnimi i punonjësve që do të hedhin të dhëna ose do të gjenerojnë analiza					
3	Njohja e punonjësve me detyrimet e tyre në respektimin e afateve të plotësimit të të dhënave dhe gjenerimit të analizave					
	<b>Shuma</b>					0
<b>f) Periudha e zbatimit:</b> 2025				<b>g) Ndjek zbatimin e projektit:</b> Drejtoria e Arsimit (sektori arsimit parashkollor)		

<sup>2</sup> Ky aktivitet nuk parashikon shpenzime/buxhet shtesë. Kostot përfshijnë pagat e punonjësve të angazhuar në punë, koosto që përfshijë zërat ekzistues të shpenzimeve për paga dhe kontributet e sigurimeve shoqërore.

2026	
2027	

### Risqet

Risku	Mitigimi
Regjistrimi i fëmijëve sipas zonës së banimit mund t'i detyrojë prindërit të regjistrojnë fëmijët në kopshte që nuk ndodhen afër vendbanimit të tyre aktual, por në kopshte që përkojnë me zonën e tyre zyrtare të banimit (sipas regjistrimit të Gjendjes Civile).	Prindërit kanë të drejtë të kërkojnë regjistrimin e fëmijës së tyre pranë vendbanimit të tyre aktual, nëse mund ta vërtetojnë këtë me dokumente zyrtare, siç janë kontratat e qirasë, kontratat e punës, ose hipotekat e shtëpive.

## 2.4 Organizmat e Institucionit Arsimor

### 2.4.1 Këshilli i Prindërve, Bordi i Kopshtit, Komisioni i Shëndetit, Sigurisë, Mirëmbajtjes dhe Mjedisit

Nga analiza e arsimit parashkollor në Bashkinë Rrogozhinë, rezulton se kopshtet që ndodhen brenda ambienteve të shkollave funksionojnë me organizmat e të shkollës dhe nuk kanë themeluar organizma të veçantë të dedikuar për kopshtin.

Në bazë të Ligjit Nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Urdhrit nr. 25, datë 25.07.2018 “Për ngritjen dhe funksionimin e bordit të institucionit arsimor”.

#### ***Ngritja e Organizmave të kopshtit***

1. Përgjegjësinë për ngritjen e organizmave të kopshtit e ka përfaqësuesi i njësisë së vetëqeverisjes vendore.
2. Përfaqësuesi i njësisë së vetëqeverisjes vendore drejton mbledhjet e këshillit të mësuesve për zgjidhjen e mësuesit në bord dhe organizon përfshirjen në bord të pjesëtarëve të tjerë nga komuniteti.

#### ***Funksionimi i Organizmave të kopshtit***

1. Bordi i kopshtit zgjidhet një herë në tre vjet dhe përsëritja e mandatit nuk është e kushtëzuar.
2. Mandati i përfaqësuesit të njësisë së vetëqeverisjes vendore bëhet një herë në katër vjet me të drejtë rizgjedhjeje.
3. Kryetari ose anëtarët e bordit largohen nga Bordi kur gjatë dy viteve të njëpasnjëshme mungon në të paktën gjysmën e mbledhjeve të tij. Bordi nëpërmjet sekretarit të tij, njofton me shkrim institucionin/organin përkatës për largimin e përfaqësuesit të tij nga bordi. Zëvendësimi i përfaqësuesit kryhet nga të njëjtat organe/institucione brenda 30 ditëve nga marrja e njoftimit, sipas procedurave të përshkruara në Udhëzimin Nr.25 datë 25.7.2018 ‘Për ngritjen dhe funksionimin e Bordit të institucionit arsimor.’”

*Objektiva specifike:*

Themelimi i Këshillit të Prindërve, Bordit të Kopshtit dhe Komisionit të Shëndetit, Sigurisë, Mirëmbajtjes dhe Mjedisit në çdo kopsht sipas Udhëzimit Nr.25 datë 25.7.2018 ‘*Për ngritjen dhe funksionimin e Bordit të institucionit arsimor.*’ dhe rritja e kapaciteteve të anëtarëve të Këshillit të Prindërve, Bordit të Kopshtit dhe Komisionit të Shëndetit, Sigurisë, Mirëmbajtjes dhe Mjedisit përsa i përket të drejtave dhe detyrimeve të tij.

*Nën-objektivat:*

<b>Nr.</b>	<b>Pershkrimi</b>
1	Ngritja e Këshillit të Prindërve
2	Ngritja e Bordit të Kopshtit
3	Ngritja e Komisionit të Shëndetit, Sigurisë, Mirëmbajtjes dhe Mjedisit në të gjithë Kopshtet.
4	Aktivizimi më i madh i Këshillit të Prindërve, Bordit të Kopshtit dhe Komisionit të Shëndetit, Sigurisë, Mirëmbajtjes dhe Mjedisit në menaxhimin e kopshtit

Lista e Aktiviteteve/Projekteve

Nr.	Projekti	Buxheti Faktik 2024	Buxhet Vit 2025	Buxhet Vit 2026	Buxhet Vit 2027	Shuma
003	Themelimi i Këshillit të Prindërve					
004	Fuqizimi i Këshillit të Prindërve					
005	Krijimi i Bordit të Kopshtit sipas Udhëzimit nr. 25					
006	Fuqizimi i Bordit të Kopshtit					
007	Ngritja e Komisionit të Shëndetit, Sigurisë, Mirëmbajtjes dhe Mjedisit					
008	Fuqizimi i Komisionit të Shëndetit, Sigurisë, Mirëmbajtjes dhe Mjedisit					

Përshkrimi i aktiviteteve/projekteve

<b>Nr. 003</b>	<b>Projekti:</b> Themelimi i Këshillit të Prindërve	<b>Programi Buxhetor:</b> 09120 - Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor <b>Funksioni:</b> 09
<b>a)Përshkrim i shkurtër i projektit</b>		
<b>i Situata</b> Kopshtet që nuk e kanë themeluar ende Këshillin e Prindërve funksionojnë brenda ambienteve të shkollave, ku organet drejtuese të shkollës mbulojnë edhe funksionet e kopshtit.Gjithashtu, jo të gjitha kopshtet i përmbushin kërkesat ligjore për numrin e anëtarëve të Këshillit, që sipas akteve ligjore duhet të jetë 6-9 anëtarë.		
<b>Përmbledhje e problematikës dhe nevoja për ndërhyrje</b> Kopshtet që funksionojnë brenda ambienteve të shkollave aktualisht përdorin Këshillin e Prindërve të shkollës për çështje që lidhen edhe me kopshtin, duke mos e krijuar një Këshill të veçantë të Prindërve për vetë kopshtin. Kjo situatë krijon sfida në përfaqësimin e duhur të interesave të prindërve dhe nevojave specifike të fëmijëve në kopsht, duke qenë se struktura e tanishme nuk adreson në mënyrë të plotë karakteristikat dhe kërkesat unike të edukimit parashkollor. <b>Nevoja për ndërhyrje</b> konsiston në krijimin e një Këshilli të veçantë të Prindërve për kopshtet, i cili do të mundësonte përfaqësim më të drejtëpërdrejtë të interesave të komunitetit të prindërve dhe do të ndihmonte në përmirësimin e menaxhimit dhe cilësisë së shërbimeve të ofruara në këto institucione.		
<b>ii Synimi i projektit</b> 1. Themelimi i Këshillit të Prindërve në çdo kopësht. 2. Kopshtet që funksionojnë me Këshillin e Prindërve të shkollës, të kenë një përfaqësues të kopshtit pjesë në Këshillin e Prindërve të shkollës. 3. Rritja e pjesëmarrjes së prindërve në Këshillat e Prindërve. Sipas Udhëzimit nr. 25, datë 25.07.2018 “Për ngritjen dhe funksionimin e bordit të institucionit arsimor”. Këshilli mund të ketë 6-9 anëtarë dhe jo të gjitha kopshtet e përmbushin këtë kriter. Bashkia nëpërmjet monitorimit të saj gjatë themelimit do të sigurojë përmbushjen e këtij standardi (bëjnë përjashtim kopshtet të cilat kanë më pak se 10 fëmijë të regjistruar).		
<b>iii Niveli i ndërhyrjes</b> 1. Kopshtet themelojnë Këshillin e Prindërve dhe i dërgojnë listën e anëtarëve Drejtorisë së Arsimit sipas Udhëzimit nr. 25, datë 25.07.2018.		

<b>iv Aktivitetet kryesore të projektit</b>						
1. Themelimi i Këshillit të Prindërve në çdo kopsht;						
<b>b) Rezultatet që prisni (shërbimet apo produktet e pritshme)</b>						
1. Themelimi i Këshillit të Prindërve në çdo kopsht sipas Udhëzimit nr. 25, datë 25.07.2018						
2. Ky proces do të rezultojë në një përfshirje më të madhe të prindërve në procesin arsimor, duke përmirësuar komunikimin midis institucioneve arsimore dhe familjeve.						
3. Zbatimi i rregullores për numrin e anëtarëve të Këshillit të Prindërve do të sigurojë përfaqësim të drejtë dhe të plotë të prindërve në të gjitha kopshtet.						
4. Kjo do të ndihmojë në balancimin e vendimmarrjes dhe në përfshirjen aktive të prindërve në aktivitete dhe vendime që lidhen me edukimin e fëmijëve të tyre.						
Aktorët e mundshëm: (njësitë e përfshira brenda bashkisë)				Kontributet e mundshme në projekt (institucione qendrore, OJF, donator, etj.)		
• Njësitë administrative				• OJF		
<b>e) Shpenzimet e llogaritura<sup>3</sup> (për çdo aktivitet të mësipërm pika iv)</b>						
Nr	Emertimi	Buxheti Faktik 2024	Buxheti Viti 2025	Buxheti Viti 2026	Buxheti Viti 2027	Shuma
1	Themelimi i Këshillit të Prindërve					
	<b>Shuma</b>					0
<b>f) Periudha e zbatimit:</b> 2025; 2026;2027				<b>g) Ndjek zbatimin e projektit:</b> Drejtoria e Arsimit (Sektori i Arsimit Parashkollor)		

<sup>3</sup> Ky aktivitet nuk parashikon shpenzime/buxhet shtesë. Kostot përfshijnë pagat e punonjësve të angazhuar në punë, koosto që përfshijë zërat ekzistues të shpenzimeve për paga dhe kontributet e sigurimeve shoqërore.

Nr. 004	Projekti: Fuqizimi i Këshillit të Prindërve	Programi Buxhetor: 09120 -Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor Funksioni: 09
<b>a)Përshkrim i shkurtër i projektit</b>		
<b>i Situata</b>		
<p><b>Sipas neni 90/pika 1:</b> Këshilli i Prindërve mbledhet të paktën tre herë në vit. Ndërkohë, numri minimal i mbledhjeve të Këshillit të Prindërve është 2, mesatarja e mbledhjeve është 2 dhe maksimumi i mbledhjeve është 3.</p>		
<p>Gjithashtu, vihet re që temat që diskutohen shpeshpër lidhen edhe me përgjegjësi të cilat nuk i zgjidh dot as këshilli dhe as vetëm kopshti.</p>		
<p>Temat që diskuton Këshilli i Prindërve dhe që kërkojnë diskutim në nivele më të larta për gjetjen e zgjidhjeve:</p>		
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Çështjet dhe problematikat që lidhen me funksionimin e kopshtit</li> <li>• Sigurimi dhe përmirësimi i mjeteve didaktike</li> <li>• Përmirësimi i standardeve të higjienës personale për fëmijët</li> <li>• Integrimi efektiv i fëmijëve që kërkojnë përfshirje sociale dhe mbështetje për vështirësitë në të nxënë.</li> <li>• Forcimi i marrëdhënieve ndërmjet kopshtit dhe komunitetit</li> </ul>		
<b>Përmbledhje e problematikës dhe nevoja për ndërhyrje</b>		
<p>Duke qenë se Këshilli i Prindërve përbën një prej aktorëve kryesorë të interesuar për një shërbim sa më të mirë të arsimit parashkollor dhe nëse funksionon vetëm formalisht, atëherë është e vështirë që shumë probleme të kopshteve, që kërkojnë edhe buxhet të madh, të jenë prioritet për Këshillin Bashkiak ose Bashkinë. Për këtë arsye është e nevojshme të trajnohen anëtarët e Këshillit të Prindërve çdo vit, në mënyrë që të adresojnë dhe ndjekin siç duhet problematikat e kopshtit.</p>		
<b>ii Synimi i projektit</b>		
<p>Nëpërmjet këtij projekti synohet:</p>		
<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Aktivizimi më i madh i Këshillit të Prindërve. Në organizimin e aktiviteteve do të kërkohej përfshirja e anëtarëve të Këshillit të Prindërve dhe në këtë mënyrë do të rritet angazhimi i tyre në kopsht.</li> </ol>		
<p>Për të fuqizuar Këshillin e Prindërve shihet tejte i nevojshëm dhe primar detajimi i Urdhrit Nr. 31, në të cilin duhet të vendosen edhe format e raportimit të Këshillit dhe rruga që ndiqet për t'i dhënë zgjidhje problemeve që mund të ngrihen nga Këshilli.</p>		
<b>iii Niveli i ndërhyrjes</b>		
<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Sektori i Arsimit organizon një takim në fillim të vitit për drejtuesit e kopshteve/mësuesit përgjegjës mbi të drejtat dhe detyrat e Këshillit të Prindërve.</li> <li>2. Drejtuesit e kopshteve organizojnë një takim me anëtarët e Këshillit të Prindërve për tu njohur me të drejtat dhe detyrat e tyre;</li> </ol>		
<b>iv Aktivitetet kryesore të projektit</b>		
<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Takim informues i drejtuesve të kopshteve nga Sektori i Arsimit parashkollor;</li> <li>2. Bashkebledhimi i anëtarëve të Këshillit të Prindërve me drejtuesit e kopshteve.</li> <li>3. Të ftohen të gjithë prindërit, gjatë periudhës që zhvillohen degjesat e buxhetit, në këtë mënyrë prindërit aktivizohen dhe bëhen pjesë e vendimmarrjes.</li> </ol>		
<b>b) Rezultatet që prisni (shërbimet apo produktet e pritshme)</b>		
<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Njohja me të drejtat dhe detyrat e anëtarëve të Këshillit të Prindërve dhe drejtuesve;</li> <li>2. Protokoll i unifikuar mbi mënyrën se si themelohet Këshilli i Prindërve, si raportohen çështjet që diskutohen gjatë mbledhjeve dhe si marrin zgjidhje.</li> </ol>		
<p><b>Aktorët e mundshëm:</b> (njësitë e përfshira brenda bashkisë)</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Njësitë Administrative</li> </ul>	<p>Kontributet e mundshme në projekt (institucione qendrore, OJF, donator, etj.)</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• ZVAP</li> <li>• OJF</li> </ul>	

<b>e) Shpenzimet e llogaritura<sup>4</sup> (për çdo aktivitet të mësipërm pika iv)</b>						
<b>Nr</b>	<b>Emertimi</b>	<b>Buxheti Faktik 2024</b>	<b>Buxheti Viti 2025</b>	<b>Buxheti Viti 2026</b>	<b>Buxheti Viti 2027</b>	<b>Shuma</b>
1	Takim informues i drejtuesve të kopshteve					
2	Trajnimi i anëtarëve të Këshillit të Prindërve					
	<b>Shuma</b>					0
<b>f) Periudha e zbatimit:</b> 2025 2026 2027			<b>g) Ndjek zbatimin e projektit:</b> Drejtoria e Arsimit (Sektori i Arsimit Parashkollor)			

<b>Nr. 005</b>	<b>Projekti:</b> Ngritja e Bordit të Kopshtit	<b>Programi</b>	<b>Buxhetor:</b> 09120 -Arsimi bazë
----------------	---	-----------------	-------------------------------------

<sup>4</sup> Ky aktivitet nuk parashikon shpenzime/buxhet shtesë. Kostot përfshijnë pagat e punonjësve të angazhuar në punë, koosto që përfshijë zërat ekzistues të shpenzimeve për paga dhe kontributet e sigurimeve shoqërore.



sipas Udhëzimit nr. 25, datë 25.7.2018		përfshirë arsimin parashkollor <b>Funksioni: 09</b>				
<b>a) Përshkrim i shkurtër i projektit</b>						
<b>i Situata</b> Jo të gjithë kopshtet në Bashkinë Rogozhinë kanë themeluar Bordin e Kopshtit. Referuar Udhëzimit Nr. 25, datë 25.7.2018, bordi përbëhet nga 7 anëtarë, ndërkohë në kopshtet publike të Qytetit Rogozhinës, numri i anëtarëve të bordit të kopshtit është 8. Në kopshtet e qytetit të Rogozhinës numri i anëtarëve që i përkasin gjinisë “femër” është më i lartë, në krahasim me numrin e anëtarëve të gjinisë “mashkull”.						
<b>Përmbledhje e problematikës dhe nevoja për ndërhyrje</b>						
Kopshtet brenda shkollave funksionojnë me Bordin e shkollës dhe nuk e kanë themeluar më vete këtë organizëm.						
<b>ii Synimi i projektit</b> Është e nevojshme të ndërhyet për të ndarë Bordin e Kopshtit nga ai i shkollave. Nëpërmjet këtij projekti synohet: 1. Ndarja e Bordit të Kopshtit nga ai i Shkollave ku është e mundur. 2. Për kopshtet që funksionojnë me Bordin e shkollës të ketë përfaqësues dhe nga kopshti tek Bordi i shkollës, për të referuar problematikën e kopshtit.						
<b>iii Niveli i ndërhyrjes</b> 1. Themelimi i Bordit të Kopshtit në kopshte dhe dërgimi i organogramës së Bordit në Bashki. 2. Drejtuesi i kopshtit njofton Sektorin e Arsimit sa herë që Bordi i Kopshtit mbledhet dhe çështjet që diskuton duke i dërguar procesverbalët ose dokumente të tjera shtesë të mbajtura nga Sekretari i Bordit.						
<b>iv Aktivitetet kryesore të projektit</b> 1. Themelimi i Bordit të Kopshtit në çdo kopsht sipas Udhëzimit nr. 25 2. Ndarja e Bordit të Kopshtit nga ai i Shkollave.						
<b>b) Rezultatet që prisni (shërbimet apo produktet e pritshme)</b> 1. Krijimi i Bordit dhe funksioni i plotë i tij në çdo kopsht; 2. Rritja e monitorimit të Bordit të Kopshtit nga ana e Bashkisë; 3. Ndarja e Bordit të Kopshtit nga Bordi i Shkollës.						
Aktorët e mundshëm: (njësitë e përfshira brenda bashkisë) • Drejtoria e Arsimit Parashkollor • Kryetari i Bashkisë			Kontributet e mundshme në projekt (institucione qendrore, OJF, donator, etj.) • Bordi i Kopshteve • Drejtuesit e Kopshteve			
<b>e) Shpenzimet e llogaritura</b> <sup>5</sup> (për çdo aktivitet të mësipërm pika iv)						
<b>Nr</b>	<b>Emertimi</b>	<b>Buxheti Faktik 2024</b>	<b>Buxheti Viti 2025</b>	<b>Buxheti Viti 2026</b>	<b>Buxheti Viti 2027</b>	<b>Shuma</b>
1	Themelimi i Bordit të Kopshtit në çdo kopsht					
	<b>Shuma</b>					0
<b>f) Periudha e zbatimit:</b> 2025 2026 2027			<b>g) Ndjek zbatimin e projektit:</b> Drejtoria e Arsimit (Sektori i Arsimit Parashkollor)			

<b>Nr. 006</b>	<b>Projekti:</b> Fuqizimi i Bordit të Kopshtit	<b>Programi Buxhetor:</b> 09120 - Arsimi bazë
----------------	--	---

<sup>5</sup> Ky aktivitet nuk parashikon shpenzime/buxhet shtesë. Kostot përfshijnë pagat e punonjësve të angazhuar në punë, koosto që përfshijë zërat ekzistues të shpenzimeve për paga dhe kontributet e sigurimeve shoqërore.

		përfshirë arsimin parashkollor <b>Funksioni: 09</b>				
<b>a) Përshkrim i shkurtër i projektit</b>						
<b>i Situata</b> Bashkia nuk ka informacion në lidhje me mbarëvajtjen e Bordit të Kopshtit, sa herë mblidhet dhe çështjet që diskutojnë. <b>Disa nga veprimtaritë që kryhen dhe tematikat që diskutohen në bord janë:</b>						
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Merr pjesë në procedurat e emërimit e të largimit të anëtarëve të bordit</li> <li>• Shqyrton rregulloren e brendshme të institucionit</li> <li>• Ndjek përmbushjen e objektivave të planit vjetor të institucionit</li> <li>• Kontributi vullnetar i prindërve</li> <li>• Nevojat imediate të fëmijëve</li> <li>• Siguria e fëmijëve</li> <li>• Transporti i fëmijëve</li> <li>• Infrastruktura</li> </ul>						
<b>Përmbledhje e problematikës dhe nevoja për ndërhyrje</b>						
Bordi kontribuon për mbarëvajtjen e institucionit arsimor në përputhje me aktet ligjore në fuqi. Për këtë arsye është e nevojshme që të ngrihen kapacitetet e Bordit të Kopshtit, sidomos në kopshtet e NJA.						
<b>ii Synimi i projektit</b> Nëpërmjet këtij projekti synohet:						
1. Fuqizimi i Bordit të Kopshtit si organizëm që siguron mbarëvajtjen e arsimit parashkollor dhe adreson çështjet problematike për zgjidhjen e tyre.						
<b>iii Niveli i ndërhyrjes</b>						
1. Sektori i Arsimit organizon një takim informues në fillim të vitit për drejtuesit e kopshteve mbi të drejtat dhe detyrat e Bordit të Kopshtit;						
2. Drejtuesit e kopshteve organizojnë një takim me anëtarët e Bordit për t'i trajnuar mbi të drejtat dhe detyrat e tyre.						
<b>iv Aktivitetet kryesore të projektit</b>						
1. Takim informues i drejtuesve të kopshteve/kryemësuesve me Sektorin e Arsimit.						
2. Trajnimi i anëtarëve të Bordit të Kopshtit nga drejtuesit e kopshteve.						
<b>b) Rezultatet që prisni (shërbimet apo produktet e pritshme)</b>						
1. Ngritja e kapaciteteve të anëtarëve të Bordit të Kopshteve dhe drejtuesve;						
2. Rritja e ndikimit të Bordit të Kopshtit në menaxhimin e kopshteve.						
Aktorët e mundshëm: (njësitë e përfshira brenda bashkisë)			Kontributet e mundshme në projekt (institucione qendrore, OJF, donator, etj.)			
• Njësitë administrative			• OJF			
<b>e) Shpenzimet e llogaritura</b> <sup>6</sup> (për çdo aktivitet të mësipërm pika iv)						
Nr	Emertimi	Buxheti faktik 2024	Buxheti Viti 2025	Buxheti Viti 2026	Buxheti Viti 2027	Shuma
1	Trajnimi i drejtuesve të kopshteve					
2	Trajnimi i anëtarëve të Bordit të Kopshtit					
	<b>Shuma</b>					0
<b>f) Periudha e zbatimit:</b> 2025,2026,2027			<b>g) Ndjek zbatimin e projektit:</b> Drejtoria e Arsimit (Sektori i Arsimit Parashkollor)			

<b>Nr. 007</b>	<b>Projekti:</b> Ngritja e Komisionit të Shëndetit, Sigurisë, Mirëmbajtjes dhe Mjedisit	<b>Programi Buxhetor:</b> 09120 - Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor <b>Funksioni:</b> 09
----------------	---	--

<sup>6</sup> Ky aktivitet nuk parashikon shpenzime/buxhet shtesë. Kostot përfshijnë pagat e punonjësve të angazhuar në punë, koosto që përfshijë zërat ekzistues të shpenzimeve për paga dhe kontributet e sigurimeve shoqërore.

<b>a) Përshkrim i shkurtër i projektit</b>						
<b>i Situata</b> Kopshtet të cilat ndodhen brenda godinave të shkollës funksionojnë me Komisionin e Shëndetit, sigurisë, mirëmbajtjes dhe mjedisit që ka shkolla dhe nuk e kanë themeluar të dedikuar më vete për kopshtin këtë organizëm.						
<b>Përmbledhje e problematikës dhe nevoja për ndërhyrje</b>						
Disa prej detyrave kryesore të Komisionit (sipas Urdherit nr 31, date 28.01.2020 Per miratimin e rregullores per funksionimin e institucioneve arsimore ne Republiken e Shqiperise janë: a) mbikëqyr rregullisht në institucionin arsimor kushtet e ruajtjes së shëndetit, të higjienës, pastërtisë, mjedisit, të sigurisë së nxënësve dhe punonjësve dhe ruajtjen e mirëmbajtjen e mjediseve dhe të pajisjeve; b) identifikon nevojat për mirëmbajtje të institucionit; c) përcakton nevojat për ndreqje të vogla, shërbime, zëvendësime të pjesëve për shkak të dëmtimeve; d) organizon veprimtari ndërgjegjësuere me nxënës, mësues dhe prindër për kushtet e ruajtjes së shëndetit, të sigurisë, mirëmbajtjes së mjediseve e pajisjeve të institucionit.						
<b>ii Synimi i projektit</b>						
1. Ndarja e Komisionit të Shëndetit, Sigurisë, Mirëmbajtjes dhe Mjedisit të Kopshtit nga ai i Shkollës ku është e mundur; 2. Vendosja e përfaqësuesve nga kopshti në Komisionin e shendetiti të shkollës, për ato kopshte që funksionojnë me organizmat e shkollës. 3. Informimi i Bashkisë rreth problemeve dhe tematikave, të cilat diskutohet në Komision, por që është e nevojshme ndërhyrja e Bashkisë për t'i dhënë zgjidhje.						
<b>iii Niveli i ndërhyrjes</b>						
1. Themelimi i Komisionit të Shëndetit, Sigurisë, Mirëmbajtjes dhe Mjedisit në kopshte dhe dërgimi i organogramës së Komisionit në Bashki. 2. Drejtuesi i kopshtit/mësuesi përgjegjës njofton Sektorin e Arsimit parashkollor sa herë që Komisioni i Shëndetit, Sigurisë, Mirëmbajtjes dhe Mjedisit mbledhet dhe çështjet që diskuton.						
<b>iv Aktivitetet kryesore të projektit</b>						
1. Themelimi i Komisionit të Shëndetit, Sigurisë, Mirëmbajtjes dhe Mjedisit çdo vit në çdo kopsht sipas Urdherit nr 31, date 28.01.2020 Per miratimin e rregullores per funksionimin e institucioneve arsimore ne Republiken e Shqiperisë.” 2. Vendosja e përfaqësuesve të kopshtit në Komisionin e Shëndetit, Sigurisë, Mirëmbajtjes dhe Mjedisit të shkollës për të përfaqësuar kopshtin.						
<b>b) Rezultatet që prisni (shërbimet apo produktet e pritshme)</b>						
1. Krijimi i Komisionit të Shëndetit, Sigurisë, Mirëmbajtjes dhe Mjedisit dhe funksioni i plotë i tij në çdo kopsht 2. Ndarja e Komisionit të Shëndetit, Sigurisë, Mirëmbajtjes dhe Mjedisit të Kopshtit nga ai i Shkollave.						
<b>Aktorët e mundshëm:</b> (njësitë e përfshira brenda bashkisë) • Njësitë administrative				<b>Kontributet e mundshme në projekt</b> (institucione qendrore, OJF, donator, etj.)		
<b>e) Shpenzimet e llogaritura<sup>7</sup></b> (për çdo aktivitet të mësipërm pika iv)						
<b>Nr</b>	<b>Emertimi</b>	<b>Buxheti faktik 2024</b>	<b>Buxheti Viti 2025</b>	<b>Buxheti Viti 2026</b>	<b>Buxheti Viti 2027</b>	<b>Shuma</b>

<sup>7</sup> Ky aktivitet nuk parashikon shpenzime/buxhet shtesë. Kostot përfshijnë pagat e punonjësve të angazhuar në punë, koosto që përfshijë zërat ekzistues të shpenzimeve për paga dhe kontributet e sigurimeve shoqërore.

1	Themelimi i Komisionit të Shëndetit, Sigurisë, Mirëmbajtjes dhe Mjedisit çdo vit në çdo kopsht sipas Urdherit nr 31, date 28.01.2020 "Per miratimin e rregullores per funksionimin e institucioneve arsimore ne Republikën e Shqiperise"					
	<b>Shuma</b>					0
<b>f) Periudha e zbatimit:</b> 2025, 2026, 2027				<b>g) Ndjek zbatimin e projektit:</b> Drejtoria e Arsimit (Sektori i Arsimit Parashkollor)		

<b>Nr. 008</b>	<b>Projekti:</b> Fuqizimi i Komisionit të Shëndetit, Sigurisë, Mirëmbajtjes dhe Mjedisit	<b>Programi Buxhetor:</b> 09120 -Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor <b>Funksioni:</b> 09
<b>a)Përshkrim i shkurtër i projektit</b>		
<b>i Situata</b> Sipas Urdherit nr 31, date 28.01.2020 "Për miratimin e rregullores per funksionimin e institucioneve arsimore ne Republikën e Shqiperise", përsa i takon mbledhjeve të komisionit për t'i dhënë zgjidhje problematikave të krijuara në kopsht ai duhet të mblidhet për të diskutuar problemet. Sipas analizës së të dhënave Komisioni është mbledhur minimumi 2 dhe maksimumi 12 herë.		
<b>Përmbledhje e problematikës dhe nevoja për ndërhyrje</b>		
Komisini i shëndetit nuk zhvillon mbledhje aq sa është vendosur në aktet ligjore.		
<b>ii Synimi i projektit</b>		
1. Fuqizimi i Komisionit për të marrë pjesë në identifikimin e nevojave dhe për t'i dhënë zgjidhje problemeve të krijuara në kopshte.		
<b>iii Niveli i ndërhyrjes</b>		
1. Drejtuesit e Kopshteve/mësuesit përgjegjës organizojnë takime informuese me anëtarët e Komisionit për të drejtat, detyrimet e tyre dhe mënyrën e adresimit të problemeve		
<b>iv Aktivitetet kryesore të projektit</b>		
1. Takim informues i anëtarëve të Komisionit të Shëndetit, Sigurisë, Mirëmbajtjes dhe Mjedisit nga drejtuesit e kopshteve.		
<b>b) Rezultatet që prisni (shërbimet apo produktet e pritshme)</b>		
1. Ngritja e kapaciteteve të anëtarëve të Komisionit të Shëndetit, Sigurisë, Mirëmbajtjes dhe Mjedisit dhe drejtuesve të kopshteve;		
2. Rritja e përfaqësimit të çështjeve që lidhen me kopshtet në Bashki.		
<b>Aktorët e mundshëm:</b> (njësitë e përfshira brenda bashkisë)		<b>Kontributet e mundshme në projekt</b> (institucione qendrore, OJF, donator, etj.)
<ul style="list-style-type: none"> <li>Njësitë administrative</li> </ul>		<ul style="list-style-type: none"> <li>OJF</li> </ul>
<b>f) Periudha e zbatimit:</b> 2025 2026 2027		<b>g) Ndjek zbatimin e projektit:</b> 0Drejtoria e Arsimit (Sektori i Arsimit Parashkollor)

### Risqet

Risku	Mitigimi
Mungesa e drejtuesve të kopshteve mund të krijojë vështirësi për mësueset përgjegjëse, duke kufizuar mundësinë e tyre për të themeluar Bordin e kopshtit dhe për të organizuar sesionet informuese për anëtarët e Bordit. Kjo vjen si pasojë e ngarkesës së madhe me detyra që ato kanë.	Gjatë periudhës 2025-2027 do të shqyrtohet mundësia e zbatimit të Udhezimi Nr. 14 date 10.07.2023, i cili parashikon emërimin e drejtorëve për kopshtet me deri në 5 grupe fëmijësh.

## 3. Proceset Kryesore - Veprimet e Planit të Përmirësimit të Shërbimit

### 3.1 Qëllimi

Proceset kryesore janë ato procese që i shërbejnë drejtpërdrejt përmbushjes së objektivave strategjike ose qëllimit të institucionit. Këto procese ofrojnë një pjesë të konsiderueshme të performancës së një institucioni dhe konsumojnë një pjesë të konsiderueshme të burimeve. Në lidhje me kopshtet publike, fëmijët regjistrohen dhe mbërrijnë në objekt (këtu fillon procesi) dhe largohen pasi të kenë marrë arsimin parashkollor (procesi përfundon).

Plani i përmirësimit të shërbimit ka si qëllim rritjen e identifikimit, vlerësimit dhe trajtimit më të mirë të rasteve të fëmijëve pjesë e kategorive që përbëjnë rrezik për përjashtim social (fëmijët rom dhe egjiptian, fëmijët e përfshirë në skemën e ndihmës ekonomike, fëmijët jetimë, me prindër të divorcuar, fëmijë viktime të dhunës dhe abuzimit, etj), fëmijët në nevojë për mbrojtje dhe fëmijët me aftësi të kufizuar.

### 3.2 Objektiva të përgjithshëm të proceseve kryesore

Objektivat kryesore të planeve të përmirësimit në lidhje me Proceset Kryesore janë:

1. Rritja e identifikimit dhe vlerësimit të rasteve të fëmijëve në nevojë për përfshirje sociale, në nevojë për mbrojtje dhe me aftësi të kufizuar;
2. Përmirësimi i procesit të menaxhimit të rasteve të identifikuara të fëmijëve në nevojë për mbrojtje, në nevojë për përfshirje sociale dhe me aftësi të kufizuar;
3. Ngritja e një sistemi të unifikuar në nivel vendor për Bashkinë Rrogozhinë për mbledhjen e të dhënave, përpunimin dhe analizimin e tyre për të gjithë fëmijët në nevojë për përfshirje sociale;
4. Ofrimi i asistencës për fëmijët e identifikuar brenda ambientit të kopshtit. Ofrimi i shërbimit i paketës së shërbimeve psiko-sociale dhe shërbime të tjera në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese për të shmangur përjashtimin social.

### 3.3 Përfshirja sociale

#### 3.3.1 Identifikimi i nevojave për përfshirje

Referuar Ligj nr. 18/2017<sup>8</sup>, neni 50, çdo njësi administrative e bashkisë, e cila ka më shumë se 3000 fëmijë, ka minimalisht, një punonjës për mbrojtjen e fëmijës. Në rastet kur njësi administrative e bashkisë ka më pak se 3000 fëmijë, këtë detyrë mund ta kryejë njëri nga punonjësit e njësisë së vlerësimit të nevojave dhe referimit.

Referuar Urdhrit nr. 461<sup>9</sup>, dt 27/07/2022 Për një ndryshim në Urdhërin 313 datë 20/10/2020 "Për organizimin dhe funksionimin e shërbimit psiko-social në institucionet e arsimit parauniversitar dhe procedurat e emërimit, pezullimit dhe largimit në shërbimin psiko social i ndryshuar".

Shërbimi psiko-social në kopshtet dhe shkollat e arsimit bazë ofrohet në bazë të normës së përcaktuar: një psikolog ose punonjës social për çdo 300 deri në 499 nxënës (ose fëmijë).

#### Objektiva kryesore:

- Rritja e identifikimit dhe vlerësimit të rasteve të fëmijëve pjesë e kategorive që përbëjnë rrezik për përjashtim social (fëmijët rom dhe egjiptian, fëmijët e përfshirë në skemën e ndihmës ekonomike, fëmijët jetimë, me prindër të divorcuar, etj);
- Parandalimi, identifikimi, raportimi dhe menaxhimi i rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje.

#### Nën-objektivat:

Nr	Pershkrimi
1	Promovimi i rolit dhe detyrave të PMF
2	Identifikimi dhe vlerësimi i fëmijëve pjesë e kategorive që përbëjnë rrezik për përjashtim social.

#### Lista e Aktivitete/Projekteve

Nr	Projekti	Buxheti faktik 2024	Buxhet Vit 2025	Buxhet Vit 2026	Buxhet Vit 2027	Shuma periodhe
009	Promovimi i rolit dhe detyrave të PMF					
010	Fuqizimi i rolit të drejtorit në çdo institucion të arsimit parashkollor i cili do të kujdeset për zbatimin e politikave të mbrojtjes së fëmijëve në institucion.					

<sup>8</sup> Ligj nr. 18/2017 "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës" [https://www.drejtesia.gov.al/wp-content/uploads/2017/11/04\\_Ligj\\_18\\_2017\\_23.02.2017\\_Per\\_te\\_drejtat\\_dhe\\_mbrojtjen\\_e\\_femijes.pdf](https://www.drejtesia.gov.al/wp-content/uploads/2017/11/04_Ligj_18_2017_23.02.2017_Per_te_drejtat_dhe_mbrojtjen_e_femijes.pdf)

Përshkrimi i Aktiviteteve/Projekteve

<b>Nr.</b> 009	<b>Projekti:</b> Promovimi i rolit dhe detyrave te PMF	<b>Programi Buxhetor:</b> 10430-Kujdesi social për familjet dhe fëmijët <b>Funksioni:</b> 10				
<b>a) Përshkrim i shkurtër i projektit</b>						
<b>i Situata</b> Në kopshtet e bashkisë Rrogozhinë në vitin 2024 ka 6 fëmijë romë dhe 10 fëmijë egjiptian. Bazuar në të dhënat e deklaruara, rezulton se është 1 psikologe dhe 1 punonjëse sociale të cilët nuk janë të dedikuara për kopshtet, janë të bashkisë por në rast nevojë shfrytëzohen dhe nga kopshtet e Bashkisë Rrogozhinë dhe Njësive të saj Administrative.						
<b>Përmbledhje e problematikës dhe nevoja për ndërhyrje</b> Në praktikë, numri i PMF dhe punonjësit social brenda bashkisë është shumë i ulët dhe nuk arrihet të mbulohet i gjithë territori me shërbim.						
<b>ii Synimi i projektit</b> Promovimi i rolit të PMF në komunitet, nga stafet akademike te kopshteve dhe bordeve te prinderve. Stafit i kopshteve duhet të njihet me PMF, të trajnohen mbi mënyrat e identifikimit të rasteve të fëmijëve të dhunuar, të dinë si të referojnë rastin dhe të kuptojnë rolin që ka PMF për mbrojtjen e fëmijëve. Është e nevojshme të ndërtohet një urë komunikimi dhe mirëbesimi mes stafit të kopshteve dhe PMF, në mënyrë që identifikimi, referimi dhe menaxhimi i rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje të jetë sa më efikas.						
<b>iii Niveli i ndërhyrjes</b> 1. PMF si koordinues të grupeve teknike ndërsektoriale nxisin përfaqësimin e kopshteve nga një person kontakti i zgjedhur sipas VKM 149. Lind nevoja e njohjes se bazës ligjore që ngarkon të gjitha institucionet në kontakt me fëmijën të jetë pjesë e GTN. 2. NJMF dhe PMF organizojnë sesione informuese me stafin e Institucioneve arsimore të kopshteve. 3. PMF në NJA kryejnë detyrat e tyre të përcaktuara nga VKM Nr. 578, datë 3.10.2018, “Për procedurat e referimit e të menaxhimit të rastit, hartimin dhe përmbajtjen e planit individual të mbrojtjes, financimin e shpenzimeve për zbatimin e tij, si dhe zbatimin e masave të mbrojtjes”.						
<b>iv Aktivitetet kryesore të projektit</b> 1. Organizimi i takimeve informuese me stafin e kopshteve nga NJMF dhe PMF, me qëllim: o Informimin mbi rolin e PMF, së bashku dhe me Këshillin e Prindërve, Bordin e Kopshtit, Komisionin e Shëndetit o Diskutimin për çështje të mbrojtjes së fëmijëve, identifikimin e fëmijëve në nevojë për mbrojtje dhe mënyrën e adresimit të çështjes pranë PMF.						
<b>b) Rezultatet që prisni (shërbimet apo produktet e pritshme)</b> 1. Çdo institucion arsimor duhet të jetë i njohur me rolin dhe përgjegjësitë e PMF-së; 2. Numri i telefonit të strukturave të Mbrojtjes së fëmijëve duhet të jetë i afishuar në ambientet e kopshteve; 3. Çështje të mbrojtjes së fëmijëve diskutohen në mënyrë të vazhdueshme në bordin drejtues apo në këshillin e prindërve.						
Aktorët e mundshëm: (njësitë e përfshira brenda bashkisë) • Drejtoria e Shërbimeve Sociale– NJMF dhe PMF në NJA			Kontributet e mundshme në projekt (institucione qendrore, OJF, donator, etj.) • Oganizata të shoqërisë Civile të angazhuara në territory			
<b>e) Shpenzimet e llogaritura<sup>10</sup> (për çdo aktivitet të mësipërm pika iv)</b>						
<b>Nr</b>	<b>Emertimi</b>	<b>Buxheti faktik 2024</b>	<b>Buxheti Viti 2025</b>	<b>Buxheti Viti 2026</b>	<b>Buxheti Viti 2027</b>	<b>Shuma</b>
1	Takime informuese me drejtuesit e kopshteve					
2	Takime informuese me					

<sup>10</sup> Ky aktivitet nuk parashikon shpenzime/buxhet shtesë. Kostot përfshijnë pagat e punonjësve të angazhuar në punë, koosto që përfshijë zërat ekzistues të shpenzimeve për paga dhe kontributet e sigurimeve shoqërore.



	Këshillin e Prindërve, Bordin e Kopshtit dhe Komisionin e Shëndetit					
	<b>Shuma</b>					0
<b>f) Periudha e zbatimit:</b> 2025;2026; 2027			<b>g) Ndjek zbatimin e projektit:</b>			
			<ul style="list-style-type: none"> <li>Drejtoria e Arsimit (Sektori i Arsimit Parashkollor)</li> <li>Drejtoria e Shërbimeve Sociale</li> </ul>			

<b>Nr. 010</b>	<b>Projekti:</b> Fuqizimi i rolit të drejtorit në çdo institucion të arsimit parashkollor. i cili do të kujdeset për zbatimin e politikave të mbrojtjes së fëmijëve në institucion.	<b>Programi Buxhetor:</b> 09120 - Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor <b>Funksioni:</b> 09
<b>a) Përshkrim i shkurtër i projektit</b>		
<b>i Situatat</b> Pjesa më e madhe e kopshteve publike në territorin e Bashkisë Rrogozhinë ndodhen brenda godinave të shkollave. Nga 18 kopshte publike në total, vetëm 6 prej tyre janë në godinë më vete dhe 12 kopshte janë akomoduar brenda godinave të shkollave. Aktualisht në Bashkinë Rrogozhinë ka vetëm një drejtor.		
<b>Përmbledhje e problematikës dhe nevoja për ndërhyrje</b> Përsa i përket referimit të rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje, deri tani nuk ka pasur asnjë referim të ardhur nga kopshtet (mësueset, drejtuesi, etj). Por është e rëndësishme që stafi të jetë i njohur me mënyrën e referimit të çdo rasti të fëmijëve në nevojë për mbrojtje në Bashki.		
<b>ii Synimi i projektit</b> Për të rritur numrin e fëmijëve të identifikuar në nevojë për mbrojtje dhe për të siguruar trajtimin e çështjes së tyre në mënyrë efikase është e rëndësishme që drejtori i shkollës të jetë personi përgjegjës për zbatimin këtyre masave (për tu njohur me kanalet e raportimit dhe identifikimit dhe përgjegjësitë që ju takon sipas ligjit).		
<b>iii Niveli i ndërhyrjes</b> 1. Të dhënat e drejtorit/edukatores përgjegjëse i dërgohen Njesisë për Mbrojtjen e Fëmijëve në Bashki dhe PMF të NJA pas miratimit zyrtar të Politikës së Mbrojtjes së Fëmijëve nga Sektori i Arsimit. 2. Personi i kontaktit në kopsht bëhet pjesë e mekanizmit për identifikimin dhe menaxhimin e rasteve. 3. Roli i tij është të këshillojë, mbështesë dhe ndihmojë stafin në zbatimin e Politikës për Mbrojtjen e Fëmijëve. 4. Ai është burimi i parë i këshillimit dhe përkrahjes për çështjet e mbrojtjes së fëmijëve. 5. Bashkia do të ofrojë informacion të vazhdueshëm dhe profesional për mbrojtjen e fëmijëve. 6. Organizohen takimeve informuese të veçanta për personat e kontaktit për rritjen e kapaciteteve të tyre, të cilat do të realizohen nga PMF.		
<b>iv Aktivitetet kryesore të projektit</b> 1. Dërgimi i të dhënave të Personit të Kontaktit në NJMF në Bashki dhe PMF në NJA; 2. Organizimi i takimeve informuese të drejtuesve të kopshtit nga NJMF, për rritjen e kapaciteteve mbi Politikën e Mbrojtjes së Fëmijëve.		
<b>b) Rezultatet që prisni (shërbimet apo produktet e pritshme)</b> 1. Rritja e numrit të fëmijëve të identifikuar në nevojë për mbrojtje. 2. Rritje e kapaciteteve të stafit të kopshteve në lidhje me mbrojtjen e fëmijëve. 3. Menaxhimi efikas i rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje.		
Aktorët e mundshëm: (njësitë e përfshira brenda bashkisë) <ul style="list-style-type: none"> <li>Drejtoria e Shërbimit Social (NJMF, PMF)</li> </ul>		Kontributet e mundshme në projekt (institucione qendrore, OJF, donator, etj.) <ul style="list-style-type: none"> <li>OJF</li> </ul>

e) Shpenzimet e llogaritura (për çdo aktivitet të mësipërm pika iv)						
Nr	Emertimi	Buxheti faktik 2024	Buxheti Viti 2025	Buxheti Viti 2026	Buxheti Viti 2027	Shuma
1	Dërgimi i të dhënave te NJMF					
2	Takime informuese me Personat e Kontaktit					
	<b>Shuma</b>					0
f) Periudha e zbatimit: 2025;2026; 2027			g) Ndjek zbatimin e projektit: Drejtoria e Arsimit (Sektori i Arsimit Parashkollor)			

### 3.5 Fëmijët me aftësi të kufizuar

#### 3.5.1 Adresimi i prindërve

##### Informacion i përgjithshëm

E drejta për arsimim fëmijëve me aftësi ndryshe (të kufizuara) iu garantohet nga Ligji 69/2012, i ndryshuar<sup>11</sup>, Kreu XI, “Arsimimi i fëmijëve me aftësi të kufizuara”, neni 63, pika 2 (citoj): “.....Përfshirja dhe inetgrimi i fëmijëve me aftësi të kufizuara **në kopshtet dhe shkollat e zakonshme të arsimit bazë është parësore**”. Sipas udhëzimeve ligjore, zakonisht një mësuese ndihmëse ose asistente ofrohet për çdo 2-3 fëmijë me aftësi të kufizuara në një grup ose klasë. Megjithatë, ky raport mund të ndryshojë bazuar në specifikat e nevojave të fëmijëve dhe vendimet e veçanta të institucioneve arsimore dhe njësive administrative përkatëse.

##### Objektiva specifike:

- Përmirësimi i procesit të diagnostikimit të fëmijëve me aftësi të kufizuar
- Plotësimi i standardeve të aksesueshmërisë të fëmijëve me AK në arsimin parashkollor

##### Nën-objektivat:

Nr	Pershkrimi
1	Përmirësimi i komunikimit mësues-prind gjatë procesit të diagnostikimit të fëmijës nëpërmjet trajnimit të stafit të kopshteve dhe ofrimit të shërbimit psiko-social për prindërit
2	Heqja e barrierave që pengojnë aksesueshmërinë e fëmijëve me AK në kopshte

##### Lista e Aktiviteteve/Projekteve

Nr	Projekti	Buxheti faktik 2024	Buxhet Vit 2025	Buxhet Vit 2026	Buxhet Vit 2027	Shuma periudhe
011	Përmirësimi i procesit të diagnostikimit të fëmijëve me AK përmes					

<sup>11</sup>Ligji 69/2012, i ndryshuar, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”

Nr	Projekti	Buxheti faktik 2024	Buxhet Vit 2025	Buxhet Vit 2026	Buxhet Vit 2027	Shuma periudhe
	mbështetjes psiko-sociale të prindërve dhe mësuesve					
012	Vendosja e rampave dhe respektimi i standardeve për infrastrukturën e fëmijëve me AK pranë institucioneve arsimore					

*Përshkrimi i Aktiviteteve/Projekteve*

<b>Nr. 011</b>	<b>Projekti:</b> Përmirësimi i procesit të diagnostikimit të fëmijëve me AK përmes mbështetjes psiko-sociale të prindërve dhe mësuesve	<b>Programi Buxhetor:</b> 10140 -Kujdesi social për personat e sëmurë dhe me aftësi të kufizuara <b>Funksioni:</b> 10
<b>a)Përshkrim i shkurtër i projektit</b>		
<b>i Situa</b> Gjatë analizës së situatës së arsimit parashkollor është evidentuar se mësuesit e kopshteve hasin probleme me prindërit në momentin që ata dyshojnë se fëmija mund të jetë me aftësi të kufizuara.		
Përmbledhje e problematikës dhe nevoja për ndërhyrje Prindërit nuk pranojnë të vizitojnë fëmijën e tyre sepse refuzojnë të pranojnë se mund të jetë me aftësi të kufizuara mendore ose fizike.		
<b>ii Synimi i projektit</b> Ky projekt synon rritjen e ndërgjegjësimit të prindërve për rëndësinë e diagnostikimit të hershëm dhe trajtimin e specializuar të fëmijës me aftësi të kufizuara dhe asistimin e mësuesve gjatë procesit të komunikimit me prindërit.		
<b>iii Niveli i ndërhyrjes</b> 1. Hartimi i plani për organizimin e takimeve me mësuesit e arsimit parashkollor mbi mënyrat e komunikimit mësues-prind nga psikologët e Sektorit të Shërbimeve Sociale. Takimet mund të organizohen në nivel NjA për mësuesit që punojnë në kopshtet që ndodhen në zonat rurale dhe në nivel rajoni për mësuesit e kopshtin që ndodhet në qytetin e Rrogzhinës. 2. Trajnimet e organizuara në qytet nuk kanë kosto, ndërsa ato të organizuara në NjA kanë kostot e transportit; 3. Organizim i trajnimeve për mësuesit e arsimit parashkollor nga psikologët e Sektorit për Arsimin, Kulturën dhe Sportin mbi mënyrat e komunikimit mësues-prind; 4. Mësuesi njofton Sektorin për Arsimin, Kulturën dhe Sportin në rast se has një problem me prindërit përsa i përket diagnostikimit të fëmijëve me aftësi të kufizuara; 5. Sektori i Arsimit vë në dispozicion një psikolog për të trajtuar problematikën e raportuar, duke komunikuar me prindërit dhe mësuesin.		
<b>iv Aktivitetet kryesore të projektit</b> 1. Organizim i takimeve informuese nga psikologët/punonjësit social për mësuesit mbi mënyrat e komunikimit mësues-prind, për prindërit që kanë vështirësi për të pranuar se fëmijët e tyre mund të jenë me aftësi të kufizuara.		
<b>b) Rezultatet që prisni (shërbimet apo produktet e pritshme)</b> 1. Përshpejtim i procesit të diagnostikimit të fëmijëve me aftësi të kufizuara.		
Aktorët e mundshëm: (njësitë e përfshira brenda bashkisë) • Drejtoria e Shërbimit Social.	Kontributet e mundshme në projekt (institucione qendrore, OJF, donator, etj.) • OJF	

e) Shpenzimet e llogaritura <sup>12</sup> (për çdo aktivitet të mësipërm pika iv)						
Nr	Emertimi	Buxheti faktik 2024	Buxheti Viti 2025	Buxheti Viti 2026	Buxheti Viti 2027	Shuma
1	Hartimi i planit të trajnimeve për mësuesit					
3	Organizim i trajnimeve për mësuesit mbi mënyrat e komunikimit mësues-prind					
	<b>Shuma</b>					0
f) Periudha e zbatimit: 2025; 2026; 2027			g) Ndjek zbatimin e projektit: Drejtoria e Arsimit (Sektori i Arsimit Parashkollor)			

### Risqet

Risku	Mitigimi
Mungesa e fondeve të nevojshme për të financuar projektin mund të rrezikojë realizimin e tij.	Ndërmarrja e përpjekjeve për të identifikuar dhe angazhuar donatorë të mundshëm.

Nr. 012	<b>Projekti:</b> Vendosja e rampave dhe respektimi i standardeve për infrastrukturën e fëmijëve me AK pranë institucioneve arsimore	<b>Programi Buxhetor:</b> 09120 - Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor <b>Funksioni:</b> 09
<b>a) Përshkrim i shkurtër i projektit</b>		
<b>i Situata</b> Në kopshtet e Bashkisë Rogozhinë në total kemi 1 fëmijë me Aftësi të Kufizuara mendore. Kopshtet që kanë rampë janë në përgjithësi ato kopshte të cilat ndodhen brenda shkollave të rikonstruara vitet e fundit.		
<b>Përmbledhje e problematikës dhe nevoja për ndërhyrje</b> Eshtë e nevojshme që në kopshte të vendosen rampat, dhe të ndërtohen tualete për fëmijë me AK në përputhje me standardin për infrastrukturën e kopshteve. Konkretisht kopshtet që kanë nevoje për tu ndërtuar rampa janë:		
<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Kopshti Rogozhine.</li> <li>2. Kopshti Sinaballaj(Nj.Adm.Sinaballaj)</li> <li>3. Kopshti Kalush(Nj.Adm.Gose)</li> <li>4. Kopshti Gose e vogel(Nj.Adm.Gose)</li> <li>5. Kopshti Germenj(Nj.Adm.Lekaj)</li> <li>6. Kopshti Sterbeg(Nj.Adm.Kryevidh)</li> <li>7. Kopshti Zhabjak(Nj.Adm.Kryevidh)</li> <li>8. Kopshti Ballaj(Nj.Adm.Kryevidh)</li> <li>9. Kopshti Harizaj(Nj.Adm.Lekaj)</li> <li>10. Kopshti Spille(Nj.Adm.Kryevidh)</li> <li>11. Kopshti Luz i Madh(Nj.Adm.Lekaj)</li> <li>12. Kopshti Shkozet(Luz i Madh)(Nj.Adm.Lekaj)</li> </ol>		
<b>ii Synimi i projektit</b> Synimi i këtij projekti është pajisja e gjithë ndërtesave të kopshteve me rampa për të lehtësuar aksesueshmërinë e fëmijëve me aftësi të kufizuar në kopsht.		

<sup>12</sup> Ky aktivitet nuk parashikon shpenzime/buxhet shtesë. Kostot përfshijnë pagat e punonjësve të angazhuar në punë, koosto që përfshijë zërat ekzistues të shpenzimeve për paga dhe kontributet e sigurimeve shoqërore. Gjithashtu kosto të shërbimeve mbështetëse.

Në VKM nr. 1074, datë 23.12.2015, "Për përcaktimin e masave për mënjanimin e pengesave në komunikim dhe infrastrukturë në ofrimin e shërbimeve publike për personat me aftësi të kufizuara", përcaktohen masat për zbatimin dhe unifikimin e rregullave, në bazë të të cilave mënjanohen pengesat mjedisore dhe infrastrukturore për të bërë të mundur aksesin në strehim, transport, shëndetësi, kujdes social, arsimim, punësim dhe shërbime për personat me aftësi të kufizuara.

### iii Niveli i ndërhyrjes

1. Miratimi në KB i buxhetit për vendosjen e rampave dhe tualeteve në kopshte;
2. Hartimi i planit të ndërhyrjes për vendosjen e rampave dhe tualeteve në kopshte nga Drejtoria e Kontrollit të Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Drejtoria e Arsimit. Plani do të përmbajë shtrirjen kohore të ndërhyrjes, kopshtet që do të vendosen rampa çdo vit dhe kostot;

### iv Aktivitetet kryesore të projektit

1. Hartimi i planit të ndërhyrjes për vendosjen e rampave dhe ndërtimin e tualeteve në kopshte nga Drejtoria e Kontrollit të Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Drejtorinë e Arsimit;
2. Miratimi në KB i buxhetit për vendosjen e rampave dhe tualeteve në kopshte;
3. Hapja e procedurës së prokurimit publik dhe gjetja e operatorit ekonomik për vendosjen e rampave;
4. Vendosja e rampave në kopshte nga operatori ekonomik.

### b) Rezultatet që prisni (shërbimet apo produktet e pritshme)

Të gjithë kopshtet kanë rampa dhe tualete në mënyrë që fëmijët me aftësi të kufizuara të aksesojnë lehtësisht kopshtin.

**Aktorët e mundshëm:** (njësitë e përfshira brenda bashkisë)

- Drejtoria e Kontrollit të Zhvillimit të Territorit,
- Drejtoria Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse.

**Kontributet e mundshme në projekt** (institucione qendrore, OJF, donator, etj.)

- Organizata të shoqërisë civile të angazhuara në territor
- Operator/ët ekonomik

### e) Shpenzimet e llogaritura <sup>13</sup>(për çdo aktivitet të mësipërm pika iv)

Nr	Emertimi	Buxheti faktik 2024	Buxheti Viti 2025	Buxheti Viti 2026	Buxheti Viti 2027	Shuma
1	Hartimi i planit					
2	Miratimi në KB i buxhetit					
3	Vendosja e rampave në çdo kopsht.		50,000	50,000		100,000
	<b>Shuma</b>					100,000

**f) Periudha e zbatimit:**  
2025; 2026; 2027

**g) Ndjek zbatimin e projektit:**  
Drejtoria e Arsimit (Sektori i Arsimit Parashkollor)

### Risqet

Risku	Mitigimi
Mungesa e fondeve të nevojshme për të financuar projektin mund të rrezikojë realizimin e tij.	Ndërmarrja e përpjekjeve për të identifikuar dhe angazhuar donatorë të mundshëm.

<sup>13</sup> Kostot duhet të llogariten dhe të planifikohet buxheti për ndërtimin e rampave I shpërndarë sipas viteve, bazuar në vendimarrjen e Bashkisë.

## 4. Proceset Mbështetëse - Veprimet e Planit të Përmirësimit të Shërbimit

### 4.1 Qëllimi

Proceset mbështetëse ofrojnë mbështetje për proceset kryesore dhe mund të ndodhen brenda ose jashtë institucionit. Në rastin e Okopshtit, një proces mbështetës mund të jetë shtimi i burimeve njerëzore nga Bashkia për të koordinuar aktivitetet e planit të përmirësimit të arsimit parashkollor. Planet e përmirësimit synojnë ofrimin e shërbimeve më efikase në edukimin, sigurinë dhe zhvillimin e fëmijëve, si dhe sigurimin e aksesueshmërisë për të gjithë. Fokusi është në përmirësimin e infrastrukturës, ngritjen e kapaciteteve për arsimin parashkollor dhe gjithëpërfshirjen e fëmijëve në territorin e Bashkisë Rrogozhinë.

### 4.2 Objektiva të përgjithshëm

Objektivi kryesor i planeve të përmirësimit të shërbimit në lidhje me Proceset Mbështetëse është arritja e standardeve të vendosura nga aktet ligjore përsa i përket numrit të stafit të kopshteve, rikonstruksionit dhe mirëmbajtjes së godinave, llojet e materialeve didaktike, cilësinë e ushqimit dhe sigurimin e aksesit në kopsht.

### 4.3 Burimet Njerëzore

#### 4.3.1 Rekrutimi i stafit

##### *Informacion i përgjithshëm*

Institucionet arsimore parashkollore, organizohen duke u mbështetur në Urdhrin nr. 3114, Kreu II, Neni 5, “Organizimi i institucioneve të arsimit parashkollor”. Ndërsa Udhëzimi nr. 14, datë 10.7.2023 Për numrin e nxënësve për klasë dhe ngarkesën mësimore të punonjësve arsimorë.

##### *Objektiva Specifik:*

Përmirësimi i sistemit të menaxhimit të kopshteve duke siguruar nivelin e duhur të stafit përcaktuar nga aktet ligjore.

##### *Nën-objektivat:*

Nr	Pershkrimi
1	Sigurimi i zbatimit efektiv të Udhëzimit Nr. 14, datë 10.07.2023, për të rregulluar numrin e nxënësve për klasë dhe ngarkesën mësimore, duke garantuar caktimin e një edukatore për çdo 5 grupe fëmijësh në kopsht.

##### *Lista e aktiviteteve/projekteve*

Numri	Projekti	Buxheti faktik 2024	Buxhet Vit 2025	Buxhet Vit 2026	Buxhet Vit 2027	Shuma periudhe
-------	----------	---------------------	-----------------	-----------------	-----------------	----------------

<sup>14</sup> Udhëzimi Nr.14 datë 10.7.2023 Për numrin e nxënësve për klasë dhe ngarkesën mësimore të punonjësve arsimorë-  
<https://arsimi.gov.al/wp-content/uploads/2023/07/Udhezim-Nr.14-date-10.7.2023-Per-numrin-e-nxenesve-per-klase-dhe-ngarkesen-mesimore-te-punonjesve-arsimore.pdf>

Numri	Projekti	Buxheti faktik 2024	Buxhet Vit 2025	Buxhet Vit 2026	Buxhet Vit 2027	Shuma periodhe
013	Aplikimi i vendosjes si përgjegjëse të një edukatore kopshti për 5 grupe fëmijësh					

*Përshkrimi i aktiviteteve/projekteve*

<b>Nr. 013</b>	<b>Projekti:</b> Aplikimi i vendosjes si përgjegjës së një edukatore kopshti për 5 grupe fëmijësh	<b>Programi Buxhetor:</b> 09120 -Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor <b>Funksioni:</b> 09				
<b>a) Përshkrim i shkurtër i projektit</b>						
<b>i Situata</b> Drejtorë për kopshtet e Rogozhinës është vetëm 1, për kopshtin e qytetit, kopshti Rogozhinë. Kopshtet e tjera janë pa drejtues dhe janë nën varësinë e drejtorit të shkollës.						
<b>Përmbledhje e problematikës dhe nevoja për ndërhyrje</b> Drejtuesit e kopshteve kanë shumë detyrë të rëndësishme në menaxhimin e kopshtit dhe është e pamundur që një mësuese t'i kryejë ato. Meqë një pjesë e kopshteve ka vetëm 1 grup me fëmijë, atëherë duhet të zbatohet vendosja e 1 edukatore kopshti për 4 grupe (grupe me ushqim) dhe për 5 grupe (për grupe pa ushqim).						
<b>ii Synimi i projektit</b> 1. Menaxhimi më efikas i kopshteve; 2. Nevojat dhe problemet e kopshteve adresohen në kohën e duhur dhe institucionin e duhur, duke marrë zgjidhje më shpejt; 3. Lehtësimi i procesit të edukimit, sepse mësueset do të fokusohen vetëm në edukimin dhe menaxhimin e klasës së tyre.						
<b>iii Niveli i ndërhyrjes</b> 1. Sektori i Arsimit harton planin për se cilat edukatore do të duhen dhe cilët kopshte do të menaxhojnë;						
<b>iv Aktivitetet kryesore të projektit</b> 1. Hartimi i planit (një edukatore do të menaxhojnë disa kopshte);						
<b>b) Rezultatet që prisni (shërbimet apo produktet e pritshme)</b> 1. Menaxhimi efikas i kopshteve; 2. Zgjidhja më e shpejtë e problemeve që mund të ketë çdo kopsht; 3. Procesi i nxënies së fëmijëve më efikas.						
Aktorët e mundshëm: (njësitë e përfshira brenda bashkisë) • Drejtoria e Arsimit Parashkollor			Kontributet e mundshme në projekt (institucione qendrore, OJF, donator, etj.) • OJF			
<b>e) Shpenzimet e llogaritura<sup>15</sup> (për çdo aktivitet të mësipërm pika iv)</b>						
Nr	Emertimi	Buxheti faktik 2024	Buxheti Viti 2025	Buxheti Viti 2026	Buxheti Viti 2027	Shuma
1	Hartimi i planit dhe buxhetit qe një edukatore do të menaxhojnë disa kopshte					
2	Propozimi dhe miratimi në KB					

<sup>15</sup> Ky aktivitet nuk parashikon shpenzime/buxhet shtesë. Kostot përfshijnë pagat e punonjësve të angazhuar në punë, koosto që përfshijë zërat ekzistues të shpenzimeve për paga dhe kontributet e sigurimeve shoqërore. Gjithashtu kosto të shërbimeve mbështetëse.



<b>f) Periudha e zbatimit:</b> 2025; 2026; 2027	<b>g) Ndjek zbatimin e projektit:</b> Drejtoria e Arsimit (Sektori i Arsimit Parashkollor)
--	---

### 04.3.2 Trajnimi i stafit

#### *Informacion i përgjithshëm*

Hartimi i një marrëveshjeje bashkëpunimi midis Bashkisë dhe Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar (ZVAP) për zhvillimin e trajnimeve. Për mësuesit e arsimit parashkollor janë 3 trajnime vjetore të detyruara.

#### *Objektiva kryesore:*

Rritja e kapaciteteve të stafit të kopshteve.

#### *Nën-objektivat:*

Nr	Pershkrimi
1	Kryerja e trajnimeve vjetore akredituese të stafit të kopshteve nga ZVAP
2	Trajnimi i stafit të kopshteve për rastet e emergjencave, ndihmën e parë, përdorimin e internetit, microsoft office, etj.
3	Vlerësimi i Brendshëm i kopshteve

#### *Lista e aktiviteteve/projekteve*

Numri	Projekti	Buxheti faktik 2024	Buxhet Vit 2024	Buxhet Vit 2025	Buxhet Vit 2026	Shuma periudhe
014	Hartimi i marrëveshjes së bashkëpunimit me ZVAP					
015	Rritja e kapaciteteve të stafit të kopshteve					
016	Vlerësimi i Brendshëm i kopshteve					

*Përshkrimi i aktiviteteve/projekteve*

<b>Nr. 014</b>	<b>Projekti:</b> Hartimi i marrëveshjes së bashkëpunimit me ZVAP	<b>Programi Buxhetor:</b> 09120 -Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor <b>Funksioni:</b> 09				
<b>a) Përshkrim i shkurtër i projektit</b>						
<b>i Situata</b> Marrëveshja ndihmon në ngritjen e cilësisë së arsimit përmes trajnimeve të vazhdueshme për edukatorët dhe stafin e kopshteve. Trajnimet përmirësojnë njohuritë dhe aftësitë pedagogjike, duke kontribuar në një mësimdhënie më efektive dhe të qëndrueshme.						
<b>Përmbledhje e problematikës dhe nevoja për ndërhyrje</b> Edukatorët janë të detyruara të ndjekin trajnime me pagesë në institucione jo publike çdo vit. Për këtë arsye, është e nevojshme të hartohet një marrëveshje bashkëpunimi mes Bashkisë dhe ZVAP.						
<b>ii Synimi i projektit</b> Nëpërmjet marrëveshjes së bashkëpunimit synohet të arrihet pajisja çdo vit e Sektorit të Arsimit me kalendarin e trajnimeve. Sektori i Arsimit do ta dërgojë atë në çdo kopsht, në mënyrë që gjithë stafi të jetë në dijeni për kohën dhe vendndodhjen e trajnimeve.						
<b>iii Niveli i ndërhyrjes</b> 1. Hartimi i një marrëveshjeje bashkëpunimi mes Bashkisë & ZVAP. 2. Hartimi i një marrëveshje bashkëpunimi për të siguruar zgjidhjen e problematikave ekzistuese;						
<b>iv Aktivitetet kryesore të projektit</b> 1. Organizimi i takimit mes përfaqësuesve të Sektorit të Arsimit dhe ZVAP; 2. Hartimi dhe firmosja e marrëveshjes së bashkëpunimit.						
<b>b) Rezultatet që prisni (shërbimet apo produktet e pritshme)</b> 1. Kryerja e trajnimeve akredituese të stafit të IA; 2. Rritja e kapaciteteve të stafit të IA; 3. Përmirësimi i procesit të Vlerësimit të Brendshëm të kopshteve.						
Aktorët e mundshëm: (njësitë e përfshira brenda bashkisë) • Drejtoria e Arsimit			Kontributet e mundshme në projekt (institucione qendrore, OJF, donator, etj.) • ZVAP			
<b>e) Shpenzimet e llogaritura</b> <sup>16</sup> (për çdo aktivitet të mësipërm pika iv)						
Nr	Emertimi	Buxheti faktik 2024	Buxheti Viti 2025	Buxheti Viti 2026	Buxheti Viti 2027	Shuma
1	Organizimi i takimit mes përfaqësuesve të Sektorit të Arsimit dhe ZVAP					
2	Hartimi dhe firmosja e marrëveshjes së bashkëpunimit					
	<b>Shuma</b>					0
<b>f) Periudha e zbatimit:</b> 2025 2026 2027			<b>g) Ndjek zbatimin e projektit:</b> Drejtoria e Arsimit (Sektori i Arsimit Parashkollor)			

<sup>16</sup> Ky aktivitet nuk parashikon shpenzime/buxhet shtesë. Kostot përfshijnë pagat e punonjësve të angazhuar tashmë në punë, kosto që përfshijë zërat ekzistues të shpenzimeve për paga dhe kontributet e sigurimeve shoqërore.

<b>Nr. 015</b>	<b>Projekti:</b> Rritja e kapaciteteve të stafit të kopshteve	<b>Programi Buxhetor:</b> 09120 -Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor <b>Funksioni:</b> 09				
<b>a)Përshkrim i shkurtër i projektit</b>						
<b>i Situata</b> Shumica e kopshteve të Bashkisë Rrogozhinë nuk kanë dalje emergjence dhe stafi nuk është i përgatitur për mënyrën e reagimit në rastin e situatave emergjente, përfshirë këtu edhe kur mund të jetë e nevojshme dhënia e ndihmës së parë. Gjithashtu në Bashkinë Rrogozhinë operojnë disa OJF të cilat kanë si fokus primar arsimin parashkollor, mbrojtjen e fëmijëve ose përfshirjen e fëmijëve.						
<b>Përmbledhje e problematikës dhe nevoja për ndërhyrje</b>						
Një nga nevojat e Bashkisë Rrogozhinë është rritja e kapaciteteve të stafit të kopshteve për temat: 1. Ndhima e parë; 2. Reagimi në situata rreziku të godinave;						
<b>ii Synimi i projektit</b> Ky projekt synon rritjen e kapacitetit të stafit të kopshteve përsa i përket ndihmës së parë dhe reagimit në situata emergjente.						
<b>iii Niveli i ndërhyrjes</b> 1. Bashkia i kërkon Shërbimit Zjarrfikës kryerjen e trajnimeve të stafit të kopshteve për reagimin në situata zjarri, tërmeti, përmytje, etj; 2. Bashkia kontakton me Qendrat shëndetësore dhe i kërkon kryerjen e trajnimeve për Ndhimën e Parë për stafin e kopshteve; 3. Organizimi i kalendarit të trajnimeve nga Sektori i Arsimit.						
<b>iv Aktivitetet kryesore të projektit</b> 1. Bashkëpunimi me organizatat për kryerjen e trajnimeve;						
<b>b) Rezultatet që prisni (shërbimet apo produktet e pritshme)</b> 1. Rritje e kapacitetit të stafit të IA; 2. Shmangia e situatave të rrezikut dhe mbrojtja fizike e fëmijëve.						
Aktorët e mundshëm: (njësitë e përfshira brenda bashkisë) • Drejtoria e Arsimit Parashkollor			Kontributet e mundshme në projekt (institucione qendrore, OJF, donator, etj.) • Shërbimi Zjarrfikës • Qendra Shëndetësore			
<b>e) Shpenzimet e llogaritura</b> <sup>17</sup> (për çdo aktivitet të mësipërm pika iv)						
<b>Nr</b>	<b>Emertimi</b>	<b>Buxheti faktik 2024</b>	<b>Buxheti Viti 2025</b>	<b>Buxheti Viti 2026</b>	<b>Buxheti Viti 2027</b>	<b>Shuma</b>
1	Bashkëpunimi me Qendrat Shëndetësore dhe Shërbimin Zjarrfikës					
2	Kryerja e trajnimeve					0
	<b>Shuma</b>					0
<b>f) Periudha e zbatimit:</b>			<b>g) Ndjek zbatimin e projektit:</b>			

<sup>17</sup> Ky aktivitet nuk parashikon shpenzime/buxhet shtesë. Kostot përfshijnë pagat e punonjësve të angazhuar tashmë në punë, kosto që përfshijë zërat ekzistues të shpenzimeve për paga dhe kontributet e sigurimeve shoqërore. Gjithashtu edhe vendosja në dispozicion të hapësirës dhe shërbimeve mbështetëse të nevojshme të disponueshme nga Bashkia.

2025, 2026, 2027	Drejtoria e Arsimit (Sektori i Arsimit Parashkollor)
------------------	--

<b>Nr. 016</b>	<b>Projekti:</b> Vlerësimi i Brendshëm i kopshteve	<b>Programi Buxhetor:</b> 09120 -Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor <b>Funksioni:</b> 09
<b>a) Përshkrimi i shkurtër i projektit</b>		
<b>i Situata</b> Aktualisht, nuk ka një metodë të unifikuar për vlerësimin e brendshëm të kopshteve, i cili synon analizimin e pikave të forta dhe mundësive për përmirësim. Vetëvlerësimi bëhet më efektiv kur rezultatet përkthehen në plane zhvillimi që identifikojnë objektivat dhe burimet për ndryshim.		
Përmbledhje e problematikës dhe nevoja për ndërhyrje		
Sipas Urdhërit nr. 31, datë 28.01.2020 "Për miratimin e rregullores për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare në Republikën e Shqipërisë", vlerësimi i brendshëm: <ol style="list-style-type: none"> <li>1. përfshin të gjithë punonjësit arsimorë të institucionit, psikologun, punonjësin social, oficerin e sigurisë dhe sekretarin;</li> <li>2. kryhet çdo vit;</li> <li>3. mbulon të gjitha fushat që përfshin monitorimi dhe vlerësimi i IA-së;</li> <li>4. vlerësimi i brendshëm kryhet në nivel individual (drejtori, mësuesi, psikologu) dhe në nivel organizmesh.</li> </ol>		
<b>ii Synimi i projektit</b> Vlerësimi i brendshëm i kopshteve ka për qëllim përmirësimin e cilësisë së shërbimit arsimor të ofruar nga ana e tij, nëpërmjet analizës dhe reflektimit për arritjet dhe mundësitë për përmirësime. Ky projekt ka si synim hartimin e një metode të unifikuar për të gjithë kopshtet për të kryer çdo vit vlerësimin e brendshëm. Gjithashtu është shumë e rëndësishme të përcaktohen fushat mbi të cilat realizohet vlerësimi i brendshëm. Përvoja ka treguar që duhet që vlerësimi i brendshëm të ketë të njëjtat fusha mbi të cilat realizohet vlerësimi i jashtëm i kopshtit.		
<b>iii Niveli i ndërhyrjes</b> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Bashkia do tentoj të komunikoj me ZVAP për të pasur mbështetjen e tyre për bashkëpunim.</li> <li>2. Drejtuesi i kopshtit organizon një fokus grup me personat me përgjegjësi prindërore, mësuesit dhe anëtarë të tjerë të organizmave të kopshtit për të diskutuar për një numër të vogël temash ose aspektesh që lidhen me kopshtin.</li> <li>3. Koordinator i grupit, me ndihmën e koordinatorit të ZVAP, harton analizën përmbledhëse të vlerësimit të brendshëm.</li> <li>4. Rezultatet mund të përdoren për hartimin e planit afatmesëm të kopshteve ose planeve vjetore.</li> </ol>		
<b>iv Aktivitetet kryesore të projektit</b> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Hartimi i pyetësorëve për prindër, mësues dhe drejtues të kopshteve nga ZVAP;</li> <li>2. Takim informues i drejtuesve të kopshteve mbi metodën e vlerësimit të brendshëm nga ZVAP;</li> <li>3. Organizimi i fokus grupeve;</li> <li>4. Analiza dhe raportimi i rezultateve.</li> </ol>		
<b>b) Rezultatet që prisni (shërbimet apo produktet e pritshme)</b> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Kryerja çdo vit e vlerësimit të brendshëm të kopshteve sipas udhëzimit të posaçëm të MAS;</li> <li>2. Nxitja për vet-përmirësim i mësuesve, drejtuesve dhe organizmave të kopshteve;</li> <li>3. Planifikimi më objektiv bazuar në rezultatet e vlerësimit të brendshëm.</li> </ol>		
Aktorët e mundshëm: (njësitë e përfshira brenda bashkisë) <ul style="list-style-type: none"> <li>• Drejtoria e Arsimit Parashkollor</li> </ul>		Kontributet e mundshme në projekt (institucione qendrore, OJF, donator, etj.) <ul style="list-style-type: none"> <li>• ZVAP;</li> </ul>
<b>e) Shpenzimet e llogaritura<sup>18</sup></b> (për çdo aktivitet të mësipërm pika iv)		

<sup>18</sup> Ky aktivitet nuk parashikon shpenzime/buxhet shtesë. Kostot përfshijnë pagat e punonjësve të angazhuar tashmë në punë, kosto që përfshijë zërat ekzistues të shpenzimeve për paga dhe kontributet e sigurimeve

Nr	Emertimi	Buxheti faktik 2024	Buxheti Viti 2025	Buxheti Viti 2026	Buxheti Viti 2027	Shuma
1	Hartimi i pyetësorëve për prindër, mësues dhe drejtues të kopshteve					
2	Takim informues i drejtuesve të kopshteve mbi metodën e vlerësimit të brendshëm					
3	Organizimi i fokus grupeve					
4	Analiza dhe raportimi i rezultateve					
5	Rinovim i rregullores së kopshteve					
	<b>Shuma</b>					0
<b>f) Periudha e zbatimit:</b> 2025 2026 2027		<b>g) Ndjek zbatimin e projektit:</b> Drejtorja e Arsimit (Sektori i Arsimit Parashkollor)				

#### 4.4 Menaxhimi i godinave

##### 4.4.1 Rikonstruksioni i kopshteve

###### Informacion i përgjithshëm

